

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7742 E martë 18 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Edi Rama ka pasur tri qasje të ndryshme ndaj protestave të studentëve. Fillimisht, ai i trajtoi me përbuzje, duke predikuar se qytetarët nuk mund ...
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI
Rama po kërkon kamerdaren e Monës dhe Lulit


Opinion *i* **Ditës**
Rinia është një energji pozitive e Rshoqërisë, që gjithmonë duhet të merret në konsideratë me vëmendje maksimale nga më të rriturit. Të jesh i ri nuk do ...
Vijon në faqen 21

Nga MIRON ÇAKO
Protesta e të rinjve studentorë, një energji pozitive për vendin




Opozita përgatitet të ndërpresë bojkotin

Vendimi, PS-ja rrëzon dekretin e Metës për buxhetin dhe vetingun e PD

Kritikat e Pjerin Ndreut, Rama ministrave: Shkoni nëpër komisione. Gati rrezimi i Vitore Tushës

Mazhoranca e majtë do të rrëzojë këtë javë në Kuvend dekretet e Presidentit të Republikës, për kthimin e ligjit të buxhetit dhe propozimin për të zgjedhur kreun e ri të KLSH-së, si dhe propozimin e opozitës për vetingun në politikë. Qëndrimi për këto tri çështje është përcaktuar në mbledhjen e grupit parlamentar socialistë ...
Në faqen 4

MIJERA TE RINJ MBLIDHEN PARA KRYEMINISTRISË: S'KEMI FESTA, VEÇ PROTESTA

STUDENTET BLOKOJNE RRUGET, META: DEGJOJINI

Rama takon pedagogët: Mësova shumë gjëra, PD-LSI gjymtuan protestën. Basha: Mbështetje në të gjitha format, të plotësohen 8 kërkesat e të rinjve



(Në foto) Studentë të universiteteve publike në ditën e trembëdhjetë të protestës

KOMITETI KOSOVE-BE
Haradinaj kundër Mogherinit: Kush do rishikim kufijsh është armiku ynë
Në faqen 16

DEBATOHET DRAFTI
Propozimi i ri i qeverisë, këshill censure për mediat në internet
Në faqen 10

LISTA E PLOTE
Zbardhen emrat e farmacistëve që do të kryejnë provimin e shtetit
Në faqen 8-9

REKTORATI: DISTANCOHEMI
Dyshimi për libra antishqiptarë, ndalohet në kufi Panajot Barka
Në faqen 6

LISTA EMERORE



Pronarët në Tiranë dhe në rrethe që ndajnë 6 milionë euro, lista e fundit
Në faqen 11-13

Universiteti/ Aelita Mani: Në fund të kursit studentët do marrin certifikata

"Luarasi", bashkëpunim me "McCain Institute"

Profesori nga SHBA, Paul Converse Johnson, trajnim lidershpi

Nga VOLTIZA DURO

Në kuadër të bashkëpunimit me McCain Institute, Arizona State University, universiteti "Luarasi" ka zhvilluar sesionin e radhës së trajnimit "Lidershpi i udhëhequr nga karakteri". Paul Converse Johnson,



trajnujes lidershpi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë një bashkëbisedimi me studentët diskutoi rreth tipareve dalluese të një lideri për të fituar besimin e komunitetit të tij, siç janë, vlerat, etika dhe integriteti. Ai më tej i joi të rinjtë me praktikatat ...
Në faqen 7

PROTESTAT REAGIMET

Presidenti: Konsensus, komunikim politik më gjithëpërfshirës për tejkalimin e situatës

Protesta, Meta: Studentët të dëgjohen, Kuvendi të reflektojë

"Kërkesat e studentëve të drejta, të realizueshme"

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta apeloj dje qeverinë të reflektojë mbi kërkesat e studentëve. Z. Meta legjitimoi edhe një herë si të drejta kërkesat e studentëve, të cilët protestojnë prej 13 ditësh. Presidenti i vendit, Ilir Meta në fjalën e mbajtur dje në ceremoninë e diplomimit të studentëve të Akademisë shqiptare të Studimeve Politike tha se të gjitha institucionet duhet të reflektojnë me përgjegjshmëri dhe maturi përballë të rinjve shqiptarë dhe konkretisht studentëve. Ai kërkoi nga qeveria që të reflektojë mbi kërkesat e studentëve. "Nuk mund të shmang apelin e përsëritur për të reflektuar me shpejtësi, me përgjegjshmëri dhe maturi ndaj protestës së studentëve, që po zhvillohet në disa qytete kryesore të vendit. Mendoj se ka një konsensus të gjerë publik, që i konsideron kërkesat e tyre si të drejta legjitime dhe të realizueshme, ndaj zëri i tyre duhet të dëgjohet nga të gjithë", theksoi kreu i shtetit. Gjithashtu, Ilir Meta përsëriti faktin se ka besim që Kuvendi i Shqipërisë do të reflektojë pas kërkesave të studentëve, ndërsa shtoi se është i nevojshëm një konsensus dhe një komunikim politik më gjithëpërfshirës për tejkalimin e situatës. "Unë kam besim se Kuvendi i Shqipërisë do të reflektojë për një bashkëpunim gjithëpërfshirës, me qëllim plotësimin e këtyre kërkesave të drejta në interesin më të mirë jo thjesht të studentëve, por në radhë të parë në interesin më të mirë të të gjithë vendit", tha z. Meta. Sipas kreut të shtetit, pasuria më e madhe të cilës duhet t'i kushtojmë më shumë vëmendje sesa deri tani është rinia, është potenciali i saj. "Investim madhor dhe afatgjatë duhet të jetë një edukim sa më cilësor dhe i aksesueshëm për të gjithë të rinjtë. Formimi profesional i të rinjve në të gjitha fushat është domosdoshmëri. Pa bërë një ndryshim të ndjeshëm



Presidenti Ilir Meta, dje në ceremoninë e diplomimit të studentëve të Akademisë shqiptare të Studimeve Politike

VENDEMI

Në mbledhjen e djeshme të grupit parlamentar të PD-së në fokus ishte protesta e studentëve. Burime konfirmuan se në protestë nuk do të ketë deputetë të PD-së, për të shmangur akuzat e kryeministrit Edi Rama. Gjithashtu, nuk do të ketë as deputetë të LSI-së.

"PD dhe LSI gjymtuan protestën e studentëve"

Rama takon pedagogë e studentë: Mësova gjëra të reja prej tyre

Kryeministri Edi Rama takoi dje pedagogët e Fakultetit të Gjeologji Minerare dhe një grup studentësh. Për takimin informoi vetë kryeministri në një postim në "Twitter", ku shkruan se pati dialog dhe falënderon studentët e pedagogët për mikpritjen. Ai bëri të ditur se ka mësuar gjëra të reja nga studentët e pedagogët dhe ata e kuptuan ku e ka hallin ai vetë. Në mesazhin e Ramës ka edhe një "nesër". "Faleminderit për mikpritjen grupit të studentëve dhe pedagogëve të Gjeologjikut, me të cilët patëm një bashkëbisedim të dobishëm për Dialogun (e në fakt zhvilluam vetë dialogun). Mësova gjëra të reja prej tyre, mbase edhe ata e kuptuan mirë se ku e kam hallin unë. Nesër vazhdojmë", shkruan Rama. Më



herët grupe studentësh kanë bllokuar disa akse kryesore të Tiranës dhe menjëherë reagoi kryeministri në "Twitter". "A mund t'ju pyes juve që ju mësojnë doktorësia dhe artistit të bllokoni rrugët e qytetit e dyert e fakulteteve, ndërkohë që mbani bllokuar rrugën e Dialogut, duke iu hedhur në fytyrë me sharje e akuzat atyre që duan dialog. Po çfarë borxhi ju kanë juve qytetarët e studentët e tjerë", shkruan

Rama. Po dje kryeministri publikoi një foto nga sipër të studentëve protestues para Kryeministrit, duke theksuar se megjithëse protesta është gjymtuar nga ndërhyrjet opozitare, 8 kërkesat e studentëve do të adresohen. "Sharrat e doktorësia dhe britmat në gjumë të Artistit! e gjymtuan si s'ka më keq protestën tuaj! Por, unë dhe ju që s'jemi më aty, jo vetëm që s'do t'i lemë pa adresuar ato 8 pika, po do të bëjmë shumë më shumë se aq së bashku", shkroi Rama në një postim në rrjetet sociale. Kreu i ekzekutivit në fund përsëriti ftesën e tij për dialog. "Ditët po na ikin shpejt e festat po vijnë, prandaj mos rrinj po dukuni dhe t'ia nisim punën me dialog, bashkëpunim dhe këmbëngulje për universitetin".

dhe afatgjatë në kapitalin njerëzor do ta kemi të vështirë për një rritje ekonomike më të lartë, më të qëndrueshme dhe më gjithëpërfshirëse", u shpreh z. Meta. Deklaratat presidenti i bëri në ceremoninë e diplomimit të studentëve të Akademisë

Politike, nga ku konstatoi se vajzat dhe zonjat mbizotërojnë në trupën e studentëve. "E vlerësoj faktin se Akademia Politike e ka rrokur më së mirë këtë qasje, duke kontribuar drejtpërdrejt në emancipimin e mëtejshëm të politikës shqiptare

dhe institucionet tona në përfaqësimin gjithnjë në rritje të grave dhe vajzave si frymëzues të një vendim-marrje dhe politikëbërjeje më të përgjegjshme, më gjithëpërfshirëse dhe njëkohësisht edhe më cilësore dhe më humane", theksoi z. Meta.



Protesta e djeshme e studentëve para Kryeministrit

BUJAR NISHANI

"Studentët shqiptarë, në protestë masive për të drejtat dhe liritë e tyre sociale dhe akademike. Kundër një kryeministri të korruptuar, i cili është kryeministri i vetëm pa një diplomë universitare që nga koha kur në Shqipëri u rrëzua diktatura komuniste dhe u vendos sistemi demokratik pluralist politik", tha ish-presidenti.

SHKURTE

Basha: PD, mbështetje studentëve në të gjitha format

PD ka qëndruar larg protestës së studentëve, duke i mbështetur ata me deklarata publike. Pas mbledhjes së grupit të deputetëve, z. Basha i bëri thirrje kryeministrit të plotësojë kërkesat e studentëve, ndërsa u zotua se do të shfuqizojë ligjin e arsimit të lartë. "Ky është momenti që të jemi të gjithë bashkë, pavarësisht bindjeve politike kundër një grushti politikanësh, kriminelësh, oligarkësh dhe pronarësh mediash, që e kanë sjellë Shqipërinë në këtë derexhe. Të jemi bashkë dhe ne sot këtë thirrje kemi. Të gjithë qytetarët të bashkohen me studentët, të bashkohen me protestën e tyre të drejtë, të mbështesin kushtet e tyre, njësoj siç i mbështesim ne", tha z. Basha. Ndonëse studentët kanë refuzuar praninë e partive politike në protestën e tyre, kreu i opozitës pas mbledhjes me deputetët u shpreh se opozita do ta mbështesë kauzën e të rinjve në të gjitha format. I vetmi që po mundohet të mbjellë frymën e përçarjes sipas kreut të demokratëve është kryeministri Rama. "PD unë e mbështesim me të gjitha format dhe mënyrat dhe natyrisht që jemi atje me mish, me shpirt e me mendje. Nuk ka nevojë të bëjmë akte protagonizmi, për t'i shërbyer pikërisht propagandës së ndyrë të Edi Ramës, i cili prej 13 ditësh po i torturon këta të rinj, të cilët kanë një kërkesë të thjeshtë: Plotëso 8 kërkesat, plotëso 8 kërkesat një orë e më parë", deklaroi z. Basha.

Banorët e Unazës së Re, në protestë: Burg për hajdutët

Banorët e "Astirit" protestuan edhe dje kundër proçekullimit e automatizimit tek Unaza e Re. Ata e cilësojnë projektin një aferë korruptive të qeverisë Rama. Në ditën e 44 të protestës, thirrjet që dominuan ishin "Qeveri e krimi", "Qeveri hajdute", "Burg për hajdutët". Në mbështetje të tyre ishin edhe deputetë të opozitës. Për skandalin e Unazës së Re, kreu i PD-së Lulzim Basha u kërkoi mediave që të pyesin kryeprokuroren Arta Marku përse nuk po e heton kryeministrin. "Shkoni vendosani këto kamera Arta Markut, pyetni se përse nuk ka nisur hetimet për Edi Ramën, i cili është planifikuesi, ideatori dhe përfituesi i vjedhjes 40 milionë euro tek Unaza", tha z. Basha.



Bllokohet trafiku te Zogu i Zi, të rinjtë: S'kemi festa. Fundviti ka veç protesta

Përshkallëzohet protesta, studentët bllokojnë edhe rrugët

Qytetarët: Zoti Rama, plotëso kërkesat!

Valentina Madani

Studentë nga të gjitha fakultetet e Universtitetit të Tiranës, atij Bujqësor, të Kamzës dhe nga rrethe të tjera të vendit u mbledhën dje në ditën e 13-të të protestës së tyre në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Protestës i janë bashkuar edhe studentët nga Korça, Elbasani, Durrësi e Shkodra. Para Kryeministrit u ngrit një podium, ku qytetarët bënin thirrje dhe shprehin mbështetjen e studentëve: "Zoti Rama, plotëso kërkesat!". Rezistenca e studentëve për plotësimin e 8 kërkesave për një arsim cilësor dhe kushte më të mira hyri dje në ditën e 13-të të saj. Studentët e nisën në mëngjes duke u grumbulluar pranë fakulteteve të tyre për të marshuar më pas nëpër rrugët kryesore të Tiranës, duke shkaktuar për disa minuta dhe bllokimin e qarkullimit. Me thirrjet: "Ejani mblidhuni këtu! S'ka negociata plotësimi kërkesat se janë shumë të qarta, S'ka gëzime s'kemi festa. Ky fundviti ka veç protesta", studentët u vendosën para Kryeministrit rreth orës 11:00. Protestës së tyre u bashkuan dhe qytetarë të thjeshtë apo studentë nga rrethet. Gjatë kohës që qëndruar para Kryeministrit pati edhe dy momente kur u hodhën tymues para derës së Kryeministrit si dhe një moment kur pati edhe tension mes studentëve dhe forcave të policisë, të cilët ndryshe nga ditët e tjera ishin shumë në të shumtë dhe qëndronin në gatishmëri. Dhjetëra qytetarë dhe studentë morën fjalën tek një podium i ngritur provizorisht para Kryeministrit dhe i bënin thirrje kryeministrit Edi Rama të plotësonte 8 kriteret, ndërsa ky i fundit u drejtohej përmes rrjeteve sociale për dialog, ndërsa shtonte se protesta kishte ngjyra politike të opozitës. "Ja ku jemi në oborrin tënd, zoti Rama. Nuk po fshihemi. Kemi paraqitur 8 kërkesat. Përse nuk na sheh? Hajde ti këtu para nesh dhe plotëso 8 kërkesat!", bërtiste një studente me megafon.




Protesta e djeshme e studentëve

MASAT
Protesta e studentëve dje vuri në lëvizje edhe Policinë e Shtetit. Pranë ambienteve të Kryeministrit është vënë re një prezencë e madhe e forcave të policisë. Masat e policisë vijnë pas paralajmërimit se protesta do të jetë mbarëkombëtare dhe studentët u kanë bërë thirrje edhe qytetarëve që t'i bashkohen kauzës së tyre.

THIRRJA

"Ja ku jemi në oborrin tënd zoti Rama. Nuk po fshihemi. Kemi paraqitur 8 kërkesat. Përse nuk na sheh? Hajde ti këtu para nesh dhe plotëso 8 kërkesat!", deklaroi një studente me megafon. "Zoti kryeministër, ose zgjidh kërkesat, ose ik, jep dorëheqjen!", u shpreh një tjetër student.



Studentët e Akademisë së Policisë, letër Ramës: Duam pagë gjatë specializimit

160 studentët të Akademisë së Sigurisë, që njëherazi janë edhe punonjës aktivë të Policisë së Shtetit, ngrenë zërin për mënyrën e trajtimit të tyre me pagë. Në letër ata shprehën se prej më shumë se 7 muajsh po shkelet vendimi i Këshillit të Ministrave, që u njeht atyre pagën gjatë specializimit. Efektivët e policisë, shumica e të cilëve kanë gradën nënkomisar, ankohen se po u mbahet në mënyrë të paligjshme 50-60% e pagës. Ata shprehën se po trajtohen me një kompensim, me vlerë nga 14 në 20 mijë lekë të reja në muaj, një shifër e papërfillshme për të përballuar nevojat personale dhe ato familjare. "Duke punuar çdo ditë, çdo orë, çdo minutë për mbrojtjen e rendit dhe sigurisë publike, për garantimin e zbatimit të ligjit, duke u përballur me vendosmëri me shkelësit e ligjit, duke luftuar çdo ditë, çdo orë, çdo minutë me krimin, na është kalitur vullneti dhe vendosmëria që të këmbëngulim që të respektohet ligji dhe të drejtat tona të mos shkelen, po ashtu si ne kërkojmë zbatimin e ligjit nga të gjithë shtetasit pa dallim", thuhet në letër. Në letër studentët i kërkojnë kreu të qeverisë të marrë masa që drejtoritë e policive të trajtojnë me paga të gjithë studentet e Akademisë. Më herët, ata i janë drejtuar edhe drejtorit të përgjithshëm, Ardi Veliu, si dhe kanë zhvilluar një takim edhe me zvmministrin Julian Hodaq, por nuk kanë gjetur zgjidhje. Çështja ka përfunduar edhe në Gjykatën Administrative, ku disa prej tyre kanë fituar të drejtën të trajtohen me pagë të plotë dhe jo me kompensim.

REZISTENCA

Rezistenca e studentëve për plotësimin e 8 kërkesave për një arsim cilësor dhe kushte më të mira hyri dje në ditën e 13-të të saj. Studentët e nisën në mëngjes duke u grumbulluar pranë fakulteteve të tyre për të marshuar më pas nëpër rrugët kryesore të Tiranës, duke shkaktuar për disa minuta dhe bllokimin e qarkullimit.

studentët të tjerë që marshuan nga fakultetet bllokuan rrugët kryesore të Tiranës, si "21 Dhjetori" dhe "Vasil Shanto". Për rreth dy orë, studentët bllokuan një nga arteriet kryesore të Tiranës, rreth-rrotullimin e "Zogut të Zi". Dhjetëra studentët bllokuan qarkullimin e automjeteve në aks, duke shkaktuar radhë të gjata në shumicën prej akseve lidhëse në zonë. Pas më shumë se dy orë bllokim, është liruar qarkullimi të "Zogu i Zi". Studentët bllokuan dje disa rrugë kryesore në Tiranë, Krugën e Elbasanit dhe rrugën të spitalet. Ndërkohë, grupi i studentëve nga Fakulteti i Shkencave Sociale mbërritën para Kryeministrit. Studentët që kishin bllokuar

shumicën prej akseve lidhëse në zonë. Pas më shumë se dy orë bllokim, është liruar qarkullimi të "Zogu i Zi". Studentët bllokuan dje disa rrugë kryesore në Tiranë, Krugën e Elbasanit dhe rrugën të spitalet. Ndërkohë, grupi i studentëve nga Fakulteti i Shkencave Sociale mbërritën para Kryeministrit. Studentët që kishin bllokuar

Bllokimi, Berisha: Dhjetëra ambulanca, në drejtim të Spitalit Ushtarak

Me dhjetëra ambulanca janë nisur pasditen e djeshme drejt Spitalit të Traumës, duke krijuar panik tek banorët e zonës. Ishte ish-kryeministri Sali Berisha, i cili postoi në "Facebook" denoncimin e qytetarëve. "Çfarë po ndodh në Laprakë drejt Spitalit të Traumës? Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital. Kaos në zonën e Laprakës. Me dhjetëra ambulanca marshojnë drejt spitalit të traumës. Po krijojnë panik dhe nuk kuptohet se çfarë po ndodh", thuhet në denoncimin drejtuar z.Berisha. Për rreth dy orë, studentët dje bllokuan një nga arteriet kryesore të Tiranës, rreth-rrotullimin e "Zogut të Zi". Dhjetëra studentët bllokuan qarkullimin e automjeteve në aks, duke shkaktuar radhë të gjata në shumicën prej akseve lidhëse në zonë. Pas më shumë se dy orë bllokim, është liruar qarkullimi tek "Zogu i Zi". Studentët nuk pranojnë negociatën dhe as dialog për plotësimin e 8 kërkesave, ndërkohë vihen re forca të shtuara policore që rrinë në gatishmëri.



qarkullimin e mjeteve janë larguar prej aty dhe janë drejtuar drejt Kryeministrit, ku do të vijojnë protestën. Protesta e djeshme u mbështet edhe nga qytetarët. Studentët protestojnë prej 13 ditësh për plotësimin e 8 kërkesave nga ana e qeverisë. Ata refuzojnë të hyjnë në bisedime me kryeministrin Rama. Nga ana e tij, kreu i qeverisë pavarësisht se thotë se i pranohet kërkesat, kërkon dialog me studentët. Nga përpara Ministrit të Arsimit, ku protestuan për shumë ditë me radhë, qendra e protestës studentore tashmë është zhvendosur përpara Kryeministrit. Ftesave të përsëritura të kryeministrit Edi Rama për dialog, studentët i janë përgjigjur prerazi me refuzim, pa plotësuar më parë 8 kërkesat e tyre.

INCIDENTI

Protesta e djeshme e studentëve para godinës së Kryeministrit u shoqërua edhe me incidente të vogla. Dikush hodhi tymues drejt Kryeministrit, por menjëherë studentët u distancuan nga ky veprim, duke thënë se nuk janë studentë ata që hodhën tymuesen. Kurse disa studentë u kapën krah për krah dhe shkuan pranë kordonit të policisë. Në këtë moment pati tension. Një student, i cili ishte pjesë e këtij tensioni tregon se çfarë ndodhi: "Vendosëm të hinqim mikrofonin dhe në mënyrë simbolike do të krijonim rrethimin e Kryeministrit duke u bërë kordon, në shenjë simbole si Kryeministria është e popullit. Nuk e kuptuan përse policia ndërhyri dhe u sollën me ne sikur të ishim kriminelë. Kordonit po ecte paralelisht me kordonin policor, kur unë u godita nga një polic për të më provokuar. Ne nuk duam dhunë, por donim të tregonim që nuk largohemi pa plotësuar kërkesat tona".

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartës gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 24.12.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shpjetën e pasurisë së paluajtshme. Arë me sipërfaqe totale 1500 m² me numër pasurie 6/90, volumni 9, fage 174, zona kadastrale 1879, e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zei Gjoka me vlerë fillestare në ankand 15.876 (Pesëmbëdhjetmijë e tetëqind e shtatëdhjet e gjashtë) EUR. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

DEKRETET KUVENDI

Rama, kritika ministrave në grup: Shkojnë në komisione, Mona në dasmë

Vendimi, mazhoranca rrëzon dekretin e Metës dhe vetingun

Socialistët, drejt rrëzimit edhe të Vitore Tushës

Mazhoranca e majtë do të rrëzojë këtë javë në Kuvend dekretin e Presidentit të Republikës, për kthimin e ligjit të buxhetit dhe propozimin për të zgjedhur kreun e ri të KLSH-së, si dhe propozimin e opozitës për vetingun në politikë. Qëndrimi për këto tri çështje është përcaktuar në mbledhjen e grupit parlamentar socialistë, ku i pranishëm ishte edhe kryeministri Edi Rama dhe ku nuk kanë munguar as debatet.

VENDIMET

Deputetët socialistë kanë vendosur që të votojnë kundër dekretit të presidentit për kthimin e buxhetit të vitit 2019 për rishqyrtim, me argumentin se nuk ka asnjë precedent të mëparshëm që të jetë kthyer për ridiskutim një ligj i tillë. Gjithashtu, ata kanë vlerësuar se as argumenti i dhënë publikisht nga presidenti nuk ka asnjë vlerë, pasi plotësimi i kërkesave të studentëve nuk lidhet domosdoshmërisht me ndryshimin e buxhetit 2018/19. Ndaj, socialistët kanë vendosur që në seancën e së enjtes të votojnë kundër këtij dekreti dhe t'i hapin rrugë hyrjes së tij më pas në fuqi. "Dekreti nuk ka lidhje me studentët. Ne nuk mund ta miratojmë. Kjo nuk i zgjidh çështjet", - tha Taulant Balla. Gjithsesi, duhet theksuar se kthimi i këtij ligji për rishqyrtim do të sjellë vonesa në hyrjen e tij në fuqi dhe për rrjedhojë do të bëjë që të ketë vonesa në pagesat buxhetore në fillim të janarit, përfshi edhe pagat e buxhetorëve. Gjithashtu, gjatë kësaj seance pritet të votohet edhe dekreti tjetër i Presidentit Meta dhe që ka të bëjë me votimin e propozimit për të zgjedhur Vitore Tushën si kryetare e Kontrollit të Lartë të Shtetit. E nëse ky dekret do hidhet për votim, socialistët kanë paralajmëruar votën e tyre kundër: "Ne e kemi vlerësuar maksimalisht kandidaturën, por ajo tashmë është pjesë e KED-së dhe ne e kemi thënë që në fillim se për ne ka më shumë rëndësi reforma në drejtësi", - tha Balla. Ndërkohë që gjatë kësaj jave do të ketë dhe një seancë të dytë dhe ajo



Gjatë një seance parlamentare

DEBATI

"Duhet që me ministrat të koordinohemi. Kemi marrëveshjen e logaridhënies. Vijnë në komision dhe debatohet, kundërshtohet, ndërsa ata e personalizojnë debatin, iu ngel hatri. Ndërkohë që ne jemi aty si ekspertë të fushës", mësohet të jetë shprehur Ndreu.

Vetingu



KOMISIONI I VENECIAS

Socialistët kanë vendosur që në bazë edhe të opinionit të Komisionit të Venecias, t'i rrëzojnë këto propozime, ndërsa seanca parashikohet të shoqërohet me diskutime dhe debate të gjata. Kjo për shkak se me këtë rast pritet të rikthehet në parlament edhe opozita.

Salianji: T'i djegim mandatet, të udhëheqim protestat

'Studentët', PD thyen bojkotin, Berisha: Në Kuvend, edhe për buxhetin

Opozita pritet të bëhet pjesë e dy seanceve parlamentare, atë të ditës së enjte dhe të premte. Shkak i thyerjes së bojkotit të gjatë të PD-së është bërë protesta e studentëve dhe buxheti për vitin e ardhshëm. Ky vendim u mor dje në mbledhjen e grupit parlamentar të PD-së. I pyetur në lidhje me rikthimin e opozitës në Kuvend, në seancën plenare të së premtes, ku është futur për votim nisma e demokratëve për vetingun, kreu Basha tha se nuk ka ende një vendim politik. Burimet shprehen se opozita do të jetë e pranishme në parlament, edhe pse në mbledhjen e grupit pati zëra që i kërkuan Lulzim Bashës djegien e mandateve të deputetëve si një akt politik për t'u prirë protestave kombëtare. Mësohet se ish-kryeministri Berisha ka kërkuar që opozita të kthehet në parlament të enjten për buxhetin, por



z.Basha e ka lënë të hapur diskutimin për mbledhjen e sotme. Mësohet gjithashtu se deputeti Salianji ka kërkuar djegien e mandateve si akt politik dhe jo prej përfundimit të afatit. "Duke e nisur nga protestat studentore, mesazhi ynë i qartë në mbështetje të tyre është qartësia politike me të cilin japim mesazhin. Nëse kemi një armik të dytë veç Edi Ramës, kemi paqartësinë. Duhet të diskutojmë mirë si grup parlamentar i PD me njëri-tjetrin, sepse nuk ka qartësi strategjike së pari në mes nesh, kjo vendim-marrje nuk është "rrahur mirë" mes nesh. Nuk duhet

t'u japim mesazh as demokratëve dhe studentëve që po presin së pari integritet nga ne, që ne do të hyjmë në seancën parlamentare, sepse na digjet mandati apo për një rrogë. Unë personalisht mendoj që duhet të djegim mandatet jo duke pritur afatin, por si akt i qartë politik, t'u bashkoimi studentëve pikërisht tani kur ata po bëjnë thirrje për gjithë shoqërinë, të bashkohemi me ta. Por nëse merret vendim që të shkojmë në parlament, të shkohet me qartësi dhe me program të qartë që zgjedhjet do t'i fitojmë duke nxjerrë kandidatët dhe alternativën që tani. E përsëris, armiku i dytë i madh ynë është paqartësia. Ndaj, dhe vendimet që merren këtu duhet së pari të jenë të vendosura bashkërisht dhe së dyti të kemi në të parët bindje dhe qartësinë se çfarë po bëjmë", është shprehur z.Salianji.

Balla: Kthimi i buxhetit, i padëgjuar ndonjëherë më parë

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla ka deklaruar dje se kthimi i buxhetit të shtetit për ridiskutim në parlament nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë në gjithë historinë e pluralizmit shqiptar. Duke folur për mediat dhe pas mbledhjes së grupit, Balla tha se buxheti është përgjegjësi e mazhorancës dhe qeverisë dhe se kthimi i tij ishte diçka që nuk ka lidhje direkte me çështjen e protestës së studentëve, siç edhe pretendon Presidenti i Republikës. "Për sa i përket dekretit për buxhetin, është e paparë dhe e padëgjuar ndonjëherë që Presidenti i Republikës të kthejë buxhetin e shtetit. Buxheti i shtetit është votuar më 3 dhjetor. Kjo nuk ka të bëjë fare me çështjen e studentëve. Unë nuk shoh asnjë lloj lidhje me këtyre të dyjave. Edhe vetë presidenti e di këtë gjë", tha Balla.



pritet të mbahet të premtën. Sipas burimeve nga PS, ajo do t'i kushtohet plotësisht çështjes së propozimeve ligjore të PD-së për vetingun në politikë. Socialistët kanë vendosur që në bazë edhe të opinionit të Komisionit të Venecias ta rrëzojnë këto propozime,

ndërsa seanca parashikohet të shoqërohet me diskutime dhe debate të gjata. Kjo, për shkak se me këtë rast pritet të rikthehet në parlament edhe opozita.

DEBATI

Ndërkohë që gjatë mbledhjes së djeshme nuk kanë munguar as debatet.

Ka qenë deputeti Pjerin Ndreu, ai që është ankuar për sjelljen e disa prej ministrave, të cilët sipas tij nuk koordinohen me deputetët dhe shumë diskutime në komisione i marrin si çështje personale. "Duhet që me ministrat të koordinohemi. Kemi marrëveshjen e llog-

aridhënies. Vijnë në komision dhe debatohet, kundërshtohet, ndërsa ata e personalizojnë debatin, iu ngel hatri. Ndërkohë që ne jemi aty si ekspertë të fushës", mësohet të jetë shprehur Ndreu. Ndërkohë që ndaj shqetësimit të tij mësohet se ka reaguar kryeministri

Rama, i cili nuk ka nguruar t'i kritikojë ministrat për sjelljen e tyre. "Pjerini ka të drejtë, por jo dhe shumë. Megjithatë, të isha unë, nuk i miratoja pa koordinim. Nga ana tjetër, ministrat shkojnë në komision si Mona në dasmë", mësohet të jetë përgjigjur Rama.



Ndonëse në kulmin e një krize politike, dy partitë politike më të mëdha në vend duket se i ruajnë kanalet e komunikimit dhe të bashkëpunimit mes tyre. Ndërsa publikisht ato kanë qenë në një konflikt të hapur, ku nuk kanë munguar akuzat e rënda kundrejt njëra-tjetrës, nga ana tjetër, larg syve të medias ato kanë arritur të merren vesh për një nga çështjet për të cilat prej disa vitesh kanë mosmarrëveshje, siç është reforma zgjedhore. PS dhe PD duket se kanë arritur një konsensus të pjesshëm mes tyre për të qenë gati për përdorimin e teknologjisë në zgjedhjet e ardhshme vendore, pra votim dhe numërim elektronik. Në fakt, një lajm të tillë e ka pohuar deputeti Bledi Çuçi, i ngarkuar nga Partia Socialiste për të ndjekur çështjet zgjedhore, duke folur në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve në Kuvendin e Shqipërisë.

Kuvendi ka zbardhur procesverbalin e kësaj mbledhje dhe aty Çuçi deklaroi se PS ka dhënë konsensusin e saj për të filluar dhe eksploruar me teknologjinë e informacionit për votimin. Madje, ai bëri të ditur se është rënë dakord që, "kryeministri të ngrejë një grup pune edhe me përfaqësinë e Partisë Demokratike", në mënyrë që t'i paraprihet procesit dhe që KQZ-ja kur të miratohet ligji, të jetë gati për të shpallur tenderin për sistemin e t'ikëtë gati termat e referencës. Pra, grupi i punës që ka ngritur kryeministri edhe me përfaqësues të PD-së po bën ndërkohë parapërgatitjet për aplikimin e teknologjisë në zgjedhjet e ardhshme, në mënyrë që të humtojë dhe testojë programe të ndryshme të teknologjisë zgjedhore. Ai për këtë dhe për të gjitha amendimet ligjore zgjedhore thekson se ekziston edhe një korrespondencë e gjerë komunikimi me përfaqësuesit e PD-së.

PROCESVERBALI I MBLËDHJES SË 22.11.2018

Gramoz Ruçi: Hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve. Me projektprogramin dhe projektkalendarin jeni njohur parapriakisht në rrugë elektronike. Projektprogrami përfshin të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend si projektligje, projektvendime, projektrezoluta etj.

Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komision dhe në seancë plenare. Dua të theksoj që, nëse mendimi i Komisionit të Venecias për nisim të opozitës për vettingun e politikanëve do të vijë brenda afateve kushtetuese për sesionin

Çuçi ka konfirmuar mirëkuptimin me PD për votimin dhe numërimin elektronik

PS-PD, konsensus për teknologjinë në zgjedhje, Rama ngre grup pune

"Kemi rënë dakord për një grup pune me përfaqësues të PD"



Komisioni Parlamentar i Reformës Zgjedhore

REFORMA

Socialistët do të synojnë që brenda këtij sesioni parlamentar, pra para Vitit të Ri, të miratojnë në Kuvend paketën e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor. Sipas Çuçit, projektligji është hartuar edhe me përfaqësinë e ekspertëve të Partisë Demokratike dhe kjo me një korrespondencë publike, e cila është e gatshme për t'u vënë në dispozicion të publikut.

mund të përfshihen ose në datën 20 ose më 27 dhjetor 2018. Megjithatë, çështja mbetet e hapur.

Lidhur me raportimin periodik të planit të veprimit të Kuvendit për përmbushjen e rekomandimeve të Progres-Raportit 2018, ka pyetje?

Vasilika Hysi: Tek forçimi i rolit kontrollues të Kuvendit në çështjet e integritetit evropian, jemi me masa të përcaktuara dhe kjo është në 'screening'.

Mimoza Pano: Kjo çështje i përket Këshillit Kombëtar të Integritetit Evropian, i cili nuk është mbledhur një herë në dy muaj, sipas përcaktimit në ligj, sepse kryetari i keshillit, si përfaqësues i opozitës nuk e ka ushtruar këtë të drejtë, megjë opozita nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve dhe në seancë plenare. Por, mund të kërkohej dhe nga 1/3 e anëtarëve të të drejtë vote të KKEE-së. 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote që mund ta mbledhim keshillin janë kryetarët e komisioneve, që mund të firmosin dhe disa përfaqësues nga shoëria civile.

Taulant Balla: Të bëjmë një kërkesë dhe ta mbledhim Këshillin Kombëtar për Integritetin Evropian më datë 4 dhjetor.

Gramoz Ruçi: Sugjerime të tjera? Zoti Çuçi, gati jemi me Reformën Zgjedhore?

Bledi Çuçi: Gati jemi, përpjekjet po bëhen. E kemi bërë të qartë që brenda dhjetorit duhet të miratohet, ndërkohë i kemi dhënë një lloj konsensusi për të filluar dhe eksploruar me punën e teknologjisë së informacionit për votimin. Kemi rënë dakord që kryeministri të ngrejë një grup pune edhe me përfaqësinë e Partisë Demokratike, në mënyrë që t'i paraprijmë procesit që KQZ-ja kur të miratohet ligji dhe kur ligji të hyjë në fuqi të jetë gati për të shpallur tenderin për sistemin e t'ikëtë gati termat e referencës. Pra, t'i bëjë grupi i punës që do të ngrihet nga kryeministri. Prandaj ky është një hap pozitiv që të kapet koha. Projektligji është hartuar edhe me përfaqësinë e ekspertëve të Partisë Demokratike dhe kjo me një korrespondencë publike, e cila është e gatshme për t'u vënë në dispozicion të publikut.

Shkarkohet kreu i Gjykatës Kushtetuese, nuk justifikoi pasurinë

Kolegji i Posaçëm i Apeleimit shkarkoi dhe kreu e Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja. Ky përbën rastin e zyrtarit më të lartë që ka rënë gjatë këtij viti në rrjetin e vettingut. Trupa e KPK-së në komunikimin e vet dhe në prani edhe të mediave arsyetoi se ai nuk kishte arritur një nivel të besueshëm në deklarimin e pasurisë. Dedja ishte konfirmuar më 13 qershor me shumicë votash nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me mendimin në favor të kryesueses Valbona Sanxhaktari dhe anëtarit të trupit gjyqës, Roland Ilija, ndërkohë relatorja e çështjes, Xhensila Pine votoi kundër konfirmimit të tij në detyrë. Vendimi i KPK u apela nga Komisioneri Publik pas rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ONM, për kriterin e pasurisë, duke arsyetuar se sa i përket kriterit të pasurisë, vendimi i



KPK-së nuk ka qenë i bazuar në prova. Kolegji i Posaçëm i Apelit i udhëhequr nga Ardian Hajdari si kryesues, Luan Daci relator dhe gjyqtaret Albana Shtylla, Rezarta Schuez dhe Natasha Mula vendosi për herë të parë të prishë një vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke pranuar arsyetimet e Komisionerit Publik, ndërsa vendosi shkarkimin e Dedjas. Gjatë parashtrimit

parlamentar, komisioni i Ligjeve dhe Këshilli i Legjislacionit duhet të mbarojë punën me shqyrtimin e

nismës. Po kështu, edhe komisioni për Reformën Zgjedhore me amendimet e Kodit Zgjedhor. Nëse opozita do të

vijë në komision, me do të ecim me qëllim që të miratohet draftin që do të paraqitet. Kam komunikuar edhe me zotin Çuçi që të më bëjë gati draftin dhe të dyja këto çështje do të jenë në axhendën e këtij sesioni parlamentar. Meqenëse jemi përpara dy të panjohurave, ne nuk e kemi përfshirë në këtë kalendar që po miratohet sot, por nëse ato do të bëhen realitet, sigurisht që

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoëria e Përmbarimit "BALIF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k. njofton Shpalljen e Ankandit të II (dytë), për shitjen e pasurisë ULLISHTE, me sip.3,400 m². Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Selzer Skraj, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me grimin fillestar në vlerën **1,904,000 (një milion e nënëshind e katër mijë) LËKË**.

Ankandi do të zhvillohet më datë 16.01.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoërisë së Përmbarimit "BALIF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k., në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon042320227, email: gjvindh@hotmail.com.



Edi Rama: Bashkëpunimi i institucioneve, i domosdoshëm

Asetet kriminale të asekuistruara në 5 vitet e fundit kapin një vlerë 5 herë më e madhe se vlera e aseteve të sekuestruara në 10 vitet e mëparshme. Kryeministri Edi Rama, i pranishëm në takim për prezantimin publik të raportit të Mon eyval të Këshillit të Europës, për vlerësimin e masave të Shqipërisë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, konfirmoi vetëdijen e plotë të qeverisë për vështirësinë dhe kompleksitetin e sfidës së ecuarisë së mëtejshme në drejtim të përmirësimit të rezultateve, si dhe angazhimin e palëkundur për të bërë maksimumin në luftën kundër pastrimit të parave nga grupet kriminale. "Dua të drejtoj ftesën për të gjitha institucionet e tjera të pranishme, qoftë institucione të lidhura me pushtetin ekzekutiv, institucione të pavarura, parlamenti etj., që të vendosin si pikën kyçe të gjithë këtyri procesi, bashkëpunimin dhe ndërveprimin, pasi pa to, suksesi nuk është i mundur dhe Shqipëria nuk mund ta hedhë hapin tjetër që ka domosdoshmërinë në vijim", tha Rama.

Reagon Omonia: Titujt nuk kanë asgjë të dyshimtë

Tentoi të fusë libra me përmbajtje antishqiptare, universiteti i Gjirokastrës: Distancohemi nga ky veprim



Pedagogu Panajot Barka

GJIROKASTËR - Dy ditë më parë, Policia Kufitare në Kakavijë ka ndaluar studiuesin dhe njëherësh shefin e Departamentit të Gjuhës greke në Universitetin e Gjirokastrës, Panajot Barka. Ai është kapur teksa kthehej nga Greqia dhe me vete kishte libra me përmbajtje antishqiptare. Gjatë një kontrolli rastësor, policia e kufirit gjeti në bagazhin e makinës së studiuesit rreth 20 libra për flisnin për Vorio Epirin. Barka ishte me gruan në makinë, kur iu gjetën librat. Studiuesi, u justifikua se librat ishin për bibliotekën e universitetit "Eqerem Çabej". Ndërkaq, ka reaguuar universiteti "Eqerem Çabej", që përmes një komunikate zyrtare distancohet nga ky akt dhe sqaron se nuk ka pasur asnjë kërkesë

REAGIMI I UNIVERSITETIT

Pas sekuestrimit nga policia të librave të pedagogut Panajot Barka, ka reaguuar universiteti "Eqerem Çabej" në Gjirokastrë. Përmes një komunikate zyrtare distancohet nga ky akt dhe sqaron se nuk ka pasur asnjë kërkesë nga ana e universitetit për libra të rinj. "Universiteti 'Eqerem Çabej' distancohet nga veprimi i z.Panajot Barka, i cili ka qenë tërësisht një veprim individual për interesa të tij dhe jo të institucionit ku është i punësuar", thuhet në deklaratë.

nga ana e universitetit për libra të rinj. "Universiteti 'Eqerem Çabej' distancohet nga veprimi i z.Panajot Barka, i cili ka qenë tërësisht një veprim individual për interesa të tij dhe jo të institucionit ku është i punësuar", thuhet në deklaratë. Librat me përmbajtje antishqiptare i janë dërguar Prokurorisë së Gjirokastrës, ndërsa Barka dhe bashkëshortja e tij janë lënë të lirë. Ndërkaq, dje

ka reaguuar dhe Omonia në lidhje me sekuestrimin të librave të pedagogut Panajot Barka. Në një njoftim për mediat, Omonia e quan një veprim të papranueshëm sekuestrimin e librave të Barkës. Gjithashtu, sipas kësaj organizate, titujt e librave që iu sekuestruan Barkës nuk kanë qenë të dyshimtë apo të rrezikshëm për popullin shqiptar. "Veprimi i papranueshëm për kufizim të lirisë të minoritetit etnik grek, sekuestrimi provizor i librave dhe tentativë për penalizim në dëm të përgjegjësit të Departamentit të Filologjisë Helenike të Universitetit të Gjirokastrës, P. Barka. Nga çdo pikëpamje çmohen të dënueshme veprimet e autoriteteve doganore dhe policore që të sekuestrojnë dhe në vijim të ngrenë akuzë për përmbajtjen e tyre, libra që nën përgjegjësinë e përgjegjësit të tij, z. Panajot Barkas, transportoheshin për

mentit të Filologjisë Helenike të Universitetit të Gjirokastrës, P. Barka. Nga çdo pikëpamje çmohen të dënueshme veprimet e autoriteteve doganore dhe policore që të sekuestrojnë dhe në vijim të ngrenë akuzë për përmbajtjen e tyre, libra që nën përgjegjësinë e përgjegjësit të tij, z. Panajot Barkas, transportoheshin për

pasurim të Bibliotekës së Departamentit të Gjuhës, Letërsisë dhe Civilizimit Helenik të Universitetit të Gjirokastrës. Ato përbëjnë dhuratë të katedrave të ndryshme dhe institucioneve universitare nga Greqia, në kuadrin e kontributit të tyre për universitetin në fjalë", thuhet ndër të tjera në reagimin e OMONIA-s.

"S'ka qasje sistematike për të hetuar aspekte të financimit të terrorizmit"

KE: Korrupsioni në Shqipëri, i lidhur me krimin e organizuar

"Autoritetet, të vetëdijshe për rreziqet, por zbatimi i ligjit ka pasur vëmendje të kufizuar"

MONEYVAL, Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Europës kundër pastrimit të parave u ka bërë thirrje autoriteteve shqiptare të shtojnë përpjekjet e tyre në ndjekjen e pasurive të parave dhe konfiskimin e aseteve të tyre, të lidhura me aktivitetet që gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme dhe në trajtimin e rreziqeve terroriste financimit të lidhura me to.

Në një raport që është shumë negativ për Shqipërinë vihet në dukje lidhja mes korrupsionit dhe organizatave kriminale për pastrimin e parave, ndërkohë që u tërhiqet vëmendja autoriteteve që ata nuk po marrin masat e duhura për të luftuar këtë fenomen. Kjo situatë ka bërë që Komisioni Europian të zgjerojë mekanizimin e saj mbikëqyrës për fenomenin e pastrimit të parave në Shqipëri. Sipas konkluzioneve të raportit, "korrupsioni paraqet rreziqe të mëdha të pastrimit të parave në Shqipëri. I lidhur shpesh me aktivitetet e krimi të organizuar, ai gjeneron sasi të konsiderueshme të të ardhurave kriminale dhe seriozisht dëmton funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë penale. Autoritetet janë të vetëdijshe për rreziqet nga korrupsioni, por zbatimi i ligjit deri më tani ka pasur një vëmendje të kufizuar për të shënjestruar korrupsionin e lidhur me pastrimin e parave. Një reformë e rëndësishme gjyqësore është duke u zbatuar për të adresuar më mirë rrezikun e korrupsionit që mbizotëron në vend". MONEYVAL pranon se autoritetet shqiptare kanë një kuptim të mirë të rreziqeve të pastrimit të parave të vendit në ekonominë formale dhe kanë mekanizma koordinues kombëtarë për politikëbërjen për të adresuar rreziqet. Megjithatë, këto mekanizma nuk kanë provuar të jenë plotësisht efektive dhe ka

RAPORTI

Në një raport që është shumë negativ për Shqipërinë vihet në dukje lidhja mes korrupsionit dhe organizatave kriminale për pastrimin e parave, ndërkohë që u tërhiqet vëmendja autoriteteve që ata nuk po marrin masat e duhura për të luftuar këtë fenomen. Kjo situatë ka bërë që Komisioni Europian të zgjerojë mekanizimin e saj mbikëqyrës për fenomenin e pastrimit të parave në Shqipëri.



RREZIKU

Sipas konkluzioneve të raportit, "korrupsioni paraqet rreziqe të mëdha të pastrimit të parave në Shqipëri. I lidhur shpesh me aktivitetet e krimi të organizuar, ai gjeneron sasi të konsiderueshme të të ardhurave kriminale dhe seriozisht dëmton funksionimin efektiv të sistemit të drejtësisë penale". MONEYVAL pranon se autoritetet shqiptare kanë një kuptim të mirë të rreziqeve të pastrimit të parave të vendit në ekonominë formale.

Ngec në "rrjetën" e vetingut gjyqitari i Apelit, Fatos Qato

TIRANË - KPK ka shkarkuar nga detyra gjyqtarin e Apelit të Tiranës, Fatos Qato, i cili ishte kandidat për anëtar në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Ai u ballafaqua me dyshimet për deklarime kontradiktore si dhe mungesë burimesh për arëdmin e shtëpisë në vlerën 25 mijë euro dhe shkollimin e fëmijëve në të njëjtën shtëpi. Por, në atë përballje, Qato e kundërshtoi analizën e KPK-së dhe tha se kishte burime të ligjshme. Gjyqtari rezultoi se ka një apartament 144 m2 në Tiranë, blerë në vitin 1997 për 28 mijë dollarë, ndërkohë që është bashkëpronar në këtë pronë. Apartamenti është hipotekuar 20 vite më vonë, në vitin 2017. KPK ka konstatuar se subjekti nuk kishte depozituar dokumentacion për të ardhurat e tij dhe bashkëshortes për vitet 1993-1997. Sipas tij, gjyqtari ka deklaruar si burim të ardhurash nga kursime familjare si dhe ndihmë nga prindërit, por ka mungesë të burimeve financiare për blerjen e apartamentit në pronësi të bashkëshortes, përfutur në vitin 2005 me kontratë dhurimi, pjesë 50%.

disa fusha ku mund të ishin arritur më shumë rezultate - thotë raportit. Ai shton se edhe hetimet e Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin rrallë rezultojnë në aktakuza dhe procedurat e pastrimit të parave të lidhura me vepra të rëndësishme, shpesh janë pezulluar nga prokuroria. Raporti nënvizon se Shqipëria ka një kornizë të fuqishme ligjore për konfiskimin e të ardhurave kriminale, por numri dhe vlera e pasurive të sekuestruara dhe

të konfiskuara nuk duket të jetë proporcionale me nivelin e kriminalitetit në vend. Në lidhje me financimin e terrorizmit, MONEYVAL vëren se perceptimi dhe të kuptuarit e rreziqeve të lidhura nuk duket se adreson në mënyrë të përshtatshme karakteristikat e veprimtarive të mundshme të financimit të terrorizmit në vend dhe në rajon. Nuk ka qasje sistematike për të identifikuar dhe për të hetuar aspekte të financimit të veprave të lidhura me terrorizmin./Monitor

U merrnin rryshfet tregtarëve ambulante, bien në pranga tre policë bashkiakë

TIRANË - Tre oficerë të Policisë Bashkiake kanë përfunduar në pranga ditën e djeshme, pasi akuzohen për shpërdorim detyre. Bëhet fjalë për shtetasit: Eduart Dafku, Hekuran Krafmani dhe Nuredin Doçi. Mësohet se arrestimi i tyre erdhi me urdhrë të Prokurorisë së Tiranës. Nga hetimet e organit të akuzës rezultoi se këta efektivë lejonin tregtarët ambulante të zinin trotuarët, duke u marrë nga 500 lekë çdo ditë. Hetimet ndaj tyre mësohet se nisën pas kallëzimit të bërë nga vetë tregtarët.

UNIVERSITETI "LUARASI" TRAJNIMI

Voltiza Duro

Në kuadër të bashkëpunimit me McCain Institute, Arizona State University, universiteti "Luarasi" ka zhvilluar sesionin e radhës së trajnimit "Leadership i udhëhequr nga karakteri". Paul Converse Johnson, trajnuesi lider shipi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë një bashkëbisedimi me studentët diskutoi rreth itipareve dalluese të një lideri për të fituar besimin e komunitetit të tij, siç janë, vlerat, etika dhe integriteti. Ai më tej i njohu të rinjtë me praktikatat më të mira të leadershipit në Amerikë.

SYNIMI

Shefja e Departamentit të Administrimit -Biznesit në "Luarasi", dr.shk. Aelita Mani tregon se ky program vjen për herë të parë në Shqipëri e është një ide inovatore për formimin e brezave. "Dua të theksoj se projektet janë projekt ide të sjella nga vetë studentët. Është një program trajnimi që zhvillohet për herë të parë në Shqipëri, dhe në të njëjtën kohë edhe në 52 vende të botës, ku për bazë ka spikatjen e karakterit, integritetit, dhe të vlerave. Është një ide inovatore për krijimin e brezave të rinj të leadershipit nëpërmjet praktikave dhe vënive në zbatim të projekt-ideve të tyre në funksion të komunitetit", tha Mani.


CERTIFIKIMI

Studentët pjesëmarrës në këtë trajnim, të cilët vijjnë nga të ndryshme të vendit, janë angazhuar vullnetarisht në komunitet me projektet e tyre personale në mbrojtje të kauzave shoqërore. Trajnimi "Leadership i udhëhequr nga karakteri" filloi në tetor të këtij viti. Në përfundim të tij, studentët do të certifikohen nga Instituti McCain në SHBA. "Mendohet që në mars ne të fillojmë turin e ri të këtij programi trajnimi për të ndihmuar studentët, të cilët kanë interes dhe duan të formo-

Trajnuesi amerikan, Paul Converse Johnson, diskutim me studentet mbi vlerat e etikën

Universiteti "Luarasi", trajnim "Leadershipi i udhëhequr nga karakteri"

Bashkëpunim me McCain Institute, Arizona University



Gjatë trajnimit në Universitetin Luarasi

mentorimi javore", u shpreh Mani. Ky program ka për qëllim krijimin e një kulture të re në përgatitjen e liderëve të brezave të ardhshëm, të cilët identifikohen nga karakteri i tyre, angazhimi për të shërbyer në një kauzë më të madhe se vetja, aty ku ka më shumë nevojë. Nëpërmjet praktikave të tilla bashkëkohore, "Luarasi" dëshmon edhe njëherë se vazhdon të mbetet një ndër liderët e arsimit të lartë në vend duke formuar profesionistët më të mirë për të ardhmen.

NDJEKJA E TRADITËS

Universiteti "Luarasi" vijon traditën e leksioneve të hapura me ekspertët më të mirë. Vetëm disa ditë më parë, studentët e Fakultetit të Drejtësisë në këtë institucion elitare, patën mundësinë e artë të ndjekin leksionin e profesores së shquar të së drejtës kushtetuese

Judithanne McLaughlan, e cila është lektore në universitetin e Floridës së Jugut. Ajo u shpjegoi studentëve funksionimin e gjykatës supreme amerikane, e cila funksionon edhe si Gjykatë Kushtetuese. E themeluar në vitin 1790, gjykata supreme cilësohet si instanca më e lartë juridike në vend. Proceset gjyqësore kryesohen nga juria e shtetit ku është kryer krimi dhe

përbëhet nga 9 anëtarë, të cilët emërohen nga presidenti, emërimi i tyre është i përgjeshëm dhe kanë trajtim të barabartë me ministrat. Pedagogia tha se përsosja e sistemit të drejtësisë në vendin e saj nuk ka qenë aspak një rrugë e lehtë, por sot gjithkush e di që në çdo gjykatë amerikane, gjyqtari do ta trajtojë me drejtësi çështjen. Dhe kjo është e rëndësishme për demokracinë. Gjithashtu, universiteti "Luarasi" priti në auditorin e tij, avokatet e njohur shqiptare, aktualisht studiuese dhe pedagoge pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Oksfordit, Rudina Jasini. Kjo e fundit është një ndër emrat më të njohur për sa i përket shumë çështjeve penale të së drejtës ndërkombëtare. Ekspertja e fushës së drejtësisë, zgjodhi pikërisht universitetin Luarasi për të dhënë leksionin e saj të parë në vendin e origjinës. Jasini ka qenë pjesë e grupit të avokatëve në mbrojtje të kryeministrit Ramush Haradinaj në Gjykatën Ndërkombëtare në Hagë. Studentët e jurisprudence në universitetin "Luarasi" shumë shpejt do të jenë avokatë, gjyqtarë dhe prokurorë. Pedagogia shqiptare e Oksfordit i sugjeron atyre të mos reshtin duke kërkuar të drejtat e tyre.

BAZA E PROGRAMIT

"Dua të theksoj se projektet janë projekt ide të sjella nga vetë studentët. Është një program trajnimi që zhvillohet për herë të parë në Shqipëri, dhe në të njëjtën kohë edhe në 52 vende të botës, ku për bazë ka spikatjen e karakterit, integritetit, dhe të vlerave. Është një ide inovatore për krijimin e brezave të rinj të leadershipit nëpërmjet praktikave dhe vënive në zbatim të projekt-ideve të tyre në funksion të komunitetit", tha Mani.

CERTIFIKATA NGA MCCAIN

"Mendohet që në mars ne të fillojmë turin e ri të këtij programi trajnimi për të ndihmuar studentët, të cilët kanë interes dhe duan të formohen në drejtësi të leadershipit. Në përfundim të këtij kursi, studentët do të pajisen me certifikata dhe ata që do ta implementojnë suksesshëm këtë projekt do të mentorohen përgjatë gjithë vitit, në seanca komunikimi dhe mentorimi javore", u shpreh Mani.

lojmë turin e ri të këtij programi trajnimi për të ndihmuar studentët, të cilët kanë interes dhe duan të formo-

hen në drejtësi të leadershipit. Në përfundim të këtij kursi, studentët do të pajisen me certifikata dhe ata që do ta

implementojnë suksesshëm këtë projekt do të mentorohen përgjatë gjithë vitit, në seanca komunikimi dhe



Qendra e Shërbimeve Arsimore: Dokumentacioni që duhet dorëzuar ditën e testit

Zbardhen emrat e farmacistëve që do t'i nënshtrohen provimit të shtetit

Lista e plotë me emrat e 303 kandidatëve që do të testohen

Voltiza Duro

Mjekët, farma cistët, stomatologët e infermierët do t'i nënshtrohen provimit të shtetit për profesionet e mjekësisë deri në fund të janarit të 2019-ës. Testimi do të zhvillohet edhe për fizioterapistët, logopedistët, mamitë, teknikët e imazherisë dhe teknikët e laboratorit. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot emrat e 303 farmacistëve që do të testohen dhe datat përkatëse për secilin kandidat. "Provimi i shtetit do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (më poshtë QSHA) me adresë: Bulevardi 'Zhan D'Ark', Nr. 23 (ish-godina e ATSH), Tiranë. Kandidati duhet të paraqitet në QSHA 30 min. para fillimit të provimit të shtetit", - thek-



son Qendra e Shërbimeve Arsimore.

DOKUMENTACIONI

Në ditën e provimit kandidatit duhet të ketë me vete letërnjoftimin (kartë ID ose pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti origjinal), faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA në një bankë të nivelit të dytë/postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA) sipas herës së pjesëmarrjes. "Për paraqitjen në

qendrat e provimit kandidati duhet të ketë parasysh rregullat e mëposhtme: ndalohet marrja me vete dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter s'kualifikimi; ndalohet duhani, dhe konsumimi i ushqimit në mjetet e provimit; ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit", - bën me dije QSHA. Kandidatët duhet të verifikojnë emrin, atësinë, mbiemrin, si dhe datën dhe orën e provimit në

faqen zyrtare të QSHA. Ligji "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" në nenin 7 thekson se personi që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

LISTA ME EMRAT E FARMACISTEVË QË I NËNSHTROHEN PROVIMIT TË SHËTETIT

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Orari										
1	Ada	Mexhit	Nasufi	19.12.2018 09:00	36	Anxhela	Arif	Gjini	19.12.2018 09:00	73	Brixhilda	Viktor	Përtena	19.12.2018 11:30
2	Adela	Sami	Gega	19.12.2018 09:00	37	Anxhela	Kujtim	Korra	19.12.2018 09:00	74	Brunilda	Zamir	Kosiqi	19.12.2018 11:30
3	Adelajda	Hafiz	Visha	19.12.2018 09:00	38	Anxhela	Arben	Selami	19.12.2018 09:00	75	Daniela	Durim	Jezeri	19.12.2018 11:30
4	Adelina	Angjelin	Feta	19.12.2018 09:00	39	Anxhela	Eqerem	Skuqi	19.12.2018 09:00	76	Dejvi	Përparim	Jazexhiu	19.12.2018 11:30
5	Adelina	Tom	Gjoka	19.12.2018 09:00	40	Anxhelo	Artur	Pepa	19.12.2018 09:00	77	Denada	Pjetri	Koçi	19.12.2018 11:30
6	Adriatik	Munir	Xhura	19.12.2018 09:00	41	Anjeza	Asllan	Aliko	19.12.2018 09:00	78	Denald	Nazmi	Kopaçi	19.12.2018 11:30
7	Aida	Llesh	Ndrejaj	19.12.2018 09:00	42	Arben	Petro	Gjini	19.12.2018 09:00	79	Denaldo	Astrit	Skrapalliu	19.12.2018 11:30
8	Alba	Ali	Novi	19.12.2018 09:00	43	Ardina	Adrian	Nuha	19.12.2018 09:00	80	Detjon	Grigor	Dedi	19.12.2018 11:30
9	Alba	Haki	Sallaku	19.12.2018 09:00	44	Ardit	Kujtim	Morina	19.12.2018 09:00	81	Diamira	Irakli	Bardhi	19.12.2018 11:30
10	Albana	Artan	Dervishi	19.12.2018 09:00	45	Aridona	Sakip	Dani	19.12.2018 09:00	82	Divino	Nazmi	Veshi	19.12.2018 11:30
11	Albana	Lavdosh	Gjikokaj	19.12.2018 09:00	46	Ariola	Avni	Osmëni	19.12.2018 09:00	83	Doriela	Kristo	Brakaj (Janku)	19.12.2018 11:30
12	Albana	Gëzim	Malai	19.12.2018 09:00	47	Arjola	Arjan	Zejnël	19.12.2018 09:00	84	Dorina	Sami	Piranej	19.12.2018 11:30
13	Albi	Kastriot	Begaj	19.12.2018 09:00	48	Arjan	Arjan	Lazareni	19.12.2018 09:00	85	Drinela	Gëzim	Cengu	19.12.2018 11:30
14	Aldo	Maksim	Hajrullaj	19.12.2018 09:00	49	Arjola	Artan	Çelmeta	19.12.2018 09:00	86	Drini	Behar	Shehi	19.12.2018 11:30
15	Algerta	Agim	Toska	19.12.2018 09:00	50	Arlind	Arjan	Seraj	19.12.2018 09:00	87	Dritan	Faik	Ago	19.12.2018 11:30
16	Alisia Gjorgjia	Eduart	Sefa	19.12.2018 09:00	51	Armand	Tomorr	Hoxha	19.12.2018 09:00	88	Dritan	Esat	Çami	19.12.2018 11:30
17	Alketa	Pellumb	Feta	19.12.2018 09:00	52	Armando	Mehdi	Meçka	19.12.2018 11:30	89	Edison	Skënder	Malaj	19.12.2018 11:30
18	Almario	Pjeter	Meci	19.12.2018 09:00	53	Arsela	Rafet	Godaj	19.12.2018 11:30	90	Edit	Munir	Vasili	19.12.2018 11:30
19	Altea	Artur	Topçiu	19.12.2018 09:00	54	Arseda	Sabri	Markja	19.12.2018 11:30	91	Edmond	Shefqet	Lozi	19.12.2018 11:30
20	Amarilda	Farudin	Lame	19.12.2018 09:00	55	Arsela	Aqif	Begtashi	19.12.2018 11:30	92	Edri	Arjan	Pollozi	19.12.2018 11:30
21	Amelda	Nuri	Xhura (Hylviu)	19.12.2018 09:00	56	Arsena	Isuf	Dashi	19.12.2018 11:30	93	Eduarta	Pashk	Boci	19.12.2018 11:30
22	Amila	Besnik	Ujkaj	19.12.2018 09:00	57	Arsit	Besnik	Hoxha	19.12.2018 11:30	94	Eklida	Avdulla	Çollaku	19.12.2018 11:30
23	Ana	Bashkim	Beqaj	19.12.2018 09:00	58	Artemis	Arjan	Dobra	19.12.2018 11:30	95	Ela	Behar	Xherri	19.12.2018 11:30
24	Ana	Ferdinand	Nikaj	19.12.2018 09:00	59	Artenisa	Skender	Baliaj	19.12.2018 11:30	96	Elda	Fadil	Duraku	19.12.2018 11:30
25	Andi	Resmi	Balla	19.12.2018 09:00	60	Aulona	Agron	Kulluri	19.12.2018 11:30	97	Elda	Fatmir	Sefa	19.12.2018 11:30
26	Andi	Nexhip	Cenaj	19.12.2018 09:00	61	Aurel	Gjergj	Alia	19.12.2018 11:30	98	Elena	Dhimitraq	Anxhara	19.12.2018 11:30
27	Andrejeva	Tomor	Thomaj	19.12.2018 09:00	62	Aurora	Shefki	Tafa	19.12.2018 11:30	99	Elidona	Kujtim	Mehmeti (Muceku)	19.12.2018 11:30
28	Aniada	Tomor	Hameli	19.12.2018 09:00	63	Bendisa	Lulezim	Hoxha	19.12.2018 11:30	100	Elona	Petrit	Xhepi	19.12.2018 11:30
29	Anila	Hysen	Çelmanaj	19.12.2018 09:00	64	Besjana	Përparim	Malka	19.12.2018 11:30	101	Elsi	Sovjet	Iljazi	19.12.2018 11:30
30	Anila	Gjergji	Maçolli	19.12.2018 09:00	65	Besnik	Ramis	Malaj	19.12.2018 11:30	102	Emanuela	Zyber	Muçça	19.12.2018 11:30
31	Anisa	Naun	Kusta	19.12.2018 09:00	66	Betina	Niko	Zaka	19.12.2018 11:30	103	Emarjola	Besnik	Lamaj (Almeta)	19.12.2018 14:00
32	Anisa	Kujtim	Topalli	19.12.2018 09:00	67	Bledi	Robert	Naçi	19.12.2018 11:30	104	Endri	Besnik	Fishta	19.12.2018 14:00
33	Anisa	Ivzi	Xhumari (Elezi)	19.12.2018 09:00	68	Blerinda	Agim	Delishaj	19.12.2018 11:30	105	Enea	Illir	Lushka	19.12.2018 14:00
34	Antigona	Lulzim	Shahinaj	19.12.2018 09:00	69	Blerta	Hysni	Leka	19.12.2018 11:30	106	Enea	Naun	Priifti	19.12.2018 14:00
35	Antueno	Luan	Pelo	19.12.2018 09:00	70	Blerta	Albert	Vathi (Rakipaj)	19.12.2018 11:30	107	Eneida	Nazmi	Abdihoxha	19.12.2018 14:00
					71	Borana	Gëzim	Zeçaj	19.12.2018 11:30					
					72	Brisilda	Vladimir	Shmili	19.12.2018 11:30					

Qeveria miraton vendimin për kompensimin financiar të atyre që u janë zënë tokat nga "informalët"

Emrat e pronarëve, si ndahen 6 milionë euro

ALUIZNI publikon listën e përfituesve në Tiranë, Elbasan, Vlorë, etj

Këshilli i Ministrave ka miratuar përdje vendimin për kompensimin financiar të pronarëve të pa surive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale, Sarandë,

Shkodër, Lezhë, Fshatra Turistikë dhe Kamzë Vorë. Dje, ALUIZNI bëri publik emrat e përfituesve.

Masa e kompensimit është 59 975,25 m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 801 927 925,69 lekë. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga

ndërtimet pa leje shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, pas miratimit nga kreditori. Gjithashtu, për një sërë parcelash, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtitimit të Pronave, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit.

AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE LISTA EMERORE E SUBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPERBLIMIT

Emër	Atesi	Mbiemër	Numi i Pronareve qe kompensohen	Emër	Atesi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
ISMET	SHERIF	MANA	637	BARDHUL	FATMR	HAXHBYSENI	490.1	12.764	6.255.636.40
			638	BALLKYZ	ISMAL	HAXHBYSENI			
			639	FLORESH A	ISMAL	HAXHBYSENI			
			640	ARBEN	FATMR	HAXHBYSENI			
			641	BARDHUL	FATMR	HAXHBYSENI			
			642	BALLKYZ	ISMAL	HAXHBYSENI			
SEFEDIN	HALIM	HASA	643	FLORESH A	ISMAL	HAXHBYSENI	472.4	12.764	6.029.713.60
			644	ARBEN	FATMR	HAXHBYSENI			
			645	AHMET		ZENELHOXHA			
			646	KAMBER		MEHUA			
BAJRAM	HASAN	MUÇA	647	MEHMET	SULEJMAN	MITASUA	568.50	12.764.00	7.256.334.00
			648	MUSTAFA		BYLYKBASHI			
RAMAZAN	SELIM	LEKA	649	HYQMET		XHERRI	106.30	12.764	1.356.813.20
			650	LINDITA		QEVANI			
			651	MERITA		KARAJ			
			652	MATEO		XHERRI			
			653	EMIN		XHERRI			
			654	VALBONA		QEVANI			
			655	MAHMUT		DORACI			
			656	MUSTAFA		BYLYKBASHI			
657	HYQMET		XHERRI						
658	LINDITA		QEVANI						
659	MERITA		KARAJ						
660	EMIN		XHERRI						
661	VALBONA		QEVANI						

Emër	Atesi	Mbiemër	Numi i Pronareve qe kompensohen	Emër	Atesi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
MAKSIM	DILAVER	RUZAJ	677	ARGJENT	XHEMAL	KALLCIU	53.17	31.270	1.662.625.90
			678	SUZANA	XHEMAL	DEMNERI			
			679	FATIME	XHEMAL	MYDERIZI			
			680	RAMOND A	BESIM	MYDINLLAR			
			681	PALMIRA	BESIM	DAJA			
			682	ARJAN	BESIM	DAJA			
			683	HATIXHE	MEHMET	DAJA			
			684	QEMAL	MEHMET	DAJA			
			685	HAMIDE	MEHMET	CASLLIDAJAJ			
			686	MEHMET					
687	CEZAR		BESHIRI						
688	PETRI		BESHIRI						

Emër	Atesi	Mbiemër	Numi i Pronareve qe kompensohen	Emër	Atesi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17

TIRANE JUG									
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2776									
BARJAM	ISMAIL	ALLKO CI	662	QERIM	SELMAN	SHEHU	354.00	878	310.812.00
			663	GANI	HAKI	MANÇAKU			
			664	FIQIRI	HAKI	MANÇAKU			
			665	HAXHUE		EGRO			
			666	ASIM	SHAQIR	DERVISHI			
			667	SADETE	HAKI	TOPI			
668	FATBARDHA		SHPENDI						
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3866									
ANTON	HILE	PJETRI	669	DONILDA	VIKTOR	SULAJ	27.67	4.242	117.376.14
MEJTE	MUHARREM	SHIMA	670	SHYQYRI	ADEM	VRAPI	500.00	4.242	2.121.000.00
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8190									
BASHKIM	ASLLAN	GJONI	671	ADA	SHABAN	REPISHTI	180.50	33.755	6.052.777.50
			672	EMA	SHABAN	PREZA			
			673	ARTUR	SHABAN	DAJA			
			674	FLAMUR	XHEMAL	KALLCIU			
			675	FATBARDH	XHEMAL	KALLCIU			
			676	GEZM	XHEMAL	KALLCIU			
			677	QERIM	SELMAN	SHEHU			
			678	GANI	HAKI	MANÇAKU			
			679	FIQIRI	HAKI	MANÇAKU			
			680	HAXHUE		EGRO			

Emër	Atesi	Mbiemër	Numi i Pronareve qe kompensohen	Emër	Atesi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
707	LIZA		MATIARYAJRIM A	257.60	33.755	8.695.288.00			
708	LIZA		MATIARYAJRIM A	96.70	33.755	3.264.108.50			
709	KRËSHNIK	SHABAN	LUSHAJ	61.70	33.755	1.745.133.50			
710	NIMETE		CELA	43.80	33.755	1.478.469.00			
711	GEZM		HYSA						
712	LUAN		MUMAJESI						
713	SOKOL		CELA						
714	HATIXHE		MUMAJESI						
715	SILVANA		KAIMI						
716	JETMIRA		HOXHA						
717	ASTRIT		KAIMI						
718	FATMR		MUMAJESI						
719	AISHE		MUMAJESI						
720	AGIM		MUMAJESI						

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompenson	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 2105

GRIGORIS	KAMBER	PRIFTI	722	YLLSON	RIZA	AGOLLI			
			723	DASHNOR	AJAZ	VISHA			
			724	SHKELQIM	QAMIL	KUPA			
							43.90	4.242	186.223.80

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976

XHEVIT	AHMET	SALLAKU	725	NAILE		MUMAJESI			
			726	BARDHYL		MUMAJESI			
			727	BAJRAM		MUMAJESI			
			728	MUBAREQ		MUMAJESI			
			729	ALBANA	SELFO	DEMI			
			730	BASHKIM	RESHIT	ARBANA			
			731	ISLAM	RESHIT	ARBANA			
			732	ARMANDO	SELFO	MOSHO			
			733	ELVUE	RESHIT	VOGLI			
			734	MAKSIM	MUHAMMEDI	MUMAJESI			
735	MIRIAM	MITHAT	MUMAJESI						
736	MILUKA	MITHAT	LATA						
737	EDMOND	MITHAT	MUMAJESI						
							389.50	479	186.570.50

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3321

ARBEN	HAMIT	MALKOLLARI	738	DASHAMIR		DERVISHI	261.00	2.560	668.160.00
SKENDER	LUL	HARIZI	739	DASHAMIR		DERVISHI	407.00	2.560	1,041.920.00
PETRIT	MEFAIL	DUKA	740	IBRAHIM	IDRIZ	CULLHAJ	163.20	2.560	417.792.00
ENGJELL	DYLEMAN	CELMETA	741	ARDJAN	ABDULLA	MUCA	309.90	2.560	793.344.00

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180

ALI	RIZA	META	742	KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE			368	31270	11,507,360.00
MEDI	RIZA	METAJ		KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE			46.8	31270	1,463,436.00
ERLET	MYQEREM	MALE		744	ADRIAN	FEJZO	FEJZO	263	31270
			745	LILIANA	FEJZO	FEJZO			
			746	MAJLINDA	FEJZO	FEJZO			
			747	SHPRESA	FEJZO	FEJZO			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976

BESNIK	ABAZ	HIDRI	748	ISMAIL	KASEM	SPAJA	68.00	479	32,572.00
--------	------	-------	-----	--------	-------	-------	-------	-----	-----------

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8190

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompenson	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
AGRON	SHYQERI	SULA	749	HATEM		HOXHA	50.3	33755	1,697,876.50
			750	IBRAHIM		HOXHA	10.7	33755	361,178.50
			751	AIDA		FRASHERI(BESHO)			
			752	ARDIAN		TOPTANI			
			753	BEHUE		ALDA(TOPTANI)			
			754	FADIL		TOPTANI			
			755	MELEQ		FRASHERI			
			756	MYNYRE		TOPTANI			
			757	HADIA		FRASHERI			
			758	NIRVANA		(FRASHERI)LEKAJ			
759	XHEMILE		TOPTANI						

TIRANE SHITESAT

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8110

FESTIM	ALI	GJUZI	760	AGRON	GANI	DELIU			
			761	SKENDER	RUSTEM	DELIU			
			762	AIDA	GANI	DELIU			
			763	BEDRUE	XHEMAL	HOLIDARI			
			764	BILAL	AZIS	DELIU			
			765	EDLIRA	GANI	MURATAJ			
			766	FATIME	RUSTEM	SHIMA			
			767	IKBALE	SEID	DELIU			
			768	ISLAM	RUSTEM	DELIU			
769	NURUE	ABDULLA	DELIU						
							422.27	23703	10,009,065.81

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8210

FATLUM	HASANI	MUSHARE	770	ALTIN	LULZIM	FORTUZI			
			771	ARBEN	XHEMAL	FORTUZI			
			772	AURORA		PAPA (MEZINI XHEHIP)			
			773	BEGIR	RAMAZAN	XHEPA			
			774	ERMAL	LULZIM	FORTUZI			
AGIM	KADRI	BABOQI	775	EVA	MEHMET	SHKEMBI			
			776	FATOS	XHEMAL	FORTUZI			
KOZETA	TOME	BABOQI	777	FLORA		LLUKMANI (MEZINI XHEPA)			
			778	GEZIM	SULEJMAN	XHEPA			
			779	HAJRIE	HAJREDIN	XHEPA			
							27.72	39614	1,070,380.08

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompenson	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
ARTAN	SINAN	BASHO	780	ILIR	MEHMET	SHKEMBI			
			781	LEJLA	XHEMAL	FORTUZI			
			782	LIRUE		JOCA (XHEPA RAMAZAN)			
LINDITA	SINAN	VASILI	783	MAHMUDI		HAXHI			
			784	MAJUCLA		RECA (SHKEMBI XHEPA)			
			785	MARGARIT		ZOI			
			786	MIRLIDA		ZAJMAJ (XHEPA SULEJMANI)			
			787	MYZEJEN		TUFINA			
			788	NDRIM		XHAVIT			
HATEME	SHAQO	LULA	789	SOKOL	XHAVIT	XHEPA			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8270

VLADIMIR	THEODHOR	TAÇE	790	ADIVUE	NEXHAT	HYDI			
QAZIM	HYSEN	ABDHOXHA	791	ASTRIT	NEXHAT	HYDI			
			792	BEKHET	NAMIK	HYDI			
			793	ERMIRA	HASAN	HYDI			
ADRIATIK	FAIK	LAMÇE	794	KUJTIM	NEXHAT	HYDI			
			795	LIRI	NAMIK	HYDI			
ERIKETA	JORGJI	LAMÇE	796	MENSUR	NEXHAT	HYDI			
			797	MIRIAM	NAMIK	HYDI			
FERDINAND	ISUF	HAXHIU	798	MYNYRE	ISAN	HYDI			
			799	NEVIN	HASAN	HYDI			
ARBEN	REFIT	RUSHITI	800	PEQER	ISAN	HYDI			
			801	REZEAR	HASAN	HYDI			
							69.00	66969	4,620,861.00

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8260

BILBIL	HYSNI	MURATAJ	802	AFERDITA	QAZIM	VORPSI			
			803	ALDA	KUJTIM	KIKA			
			804	ARJETA	MUHAMMEDI	DALIPI			
			805	AVENIR	ALI	KIKA			
SAZAN	FEJZI	SULAJ	806	BARDHYL	ALI	KIKA			
			807	FLUTURA	QAZIM	KIKA			
			808	HALIL	QAZIM	KIKA			
EDUARD	ARAJIT	REXHEPAJ	809	KLEJDA	KUJTIM	KIKA			
			810	LIRI	QAZIM	KIKA			
			811	LULEZIM	QAZIM	KIKA			
PETRIT	XHEMAL	MALINDI	812	SADETE	SHABAN	KIKA	26.10	30783	803,436.30

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar

Te dhënat e Pasurisë së Legalizuar			Kompensimi i Pronarëve						
Emër	Atësi	Mbiemër	Numeri i Pronarëve që kompenson	Emër	Atësi	Mbiemër	Masa e kompensimit (m ²)	Çmimi (leke/m ²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
1	2	3	9	10	11	12	15	16	17
ADRIAN	PETRIT	MALINDI	813	SOKOL	MUHAMMEDI	KIKA			
			814	VERA	KIKA				
			815	VJOLLCA	QAZIM	VORPSI			

QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8260

LUAN	SKENDER	BAKU	816	AFERDITA		VORPSI			
			817	ALDA		KIKA			
			818	ARJETA		PLESHTI			
			819	AVENIR		KIKA			
			820	BARDHYL		KIKA			
			821	FLUTURA		KIKA			
			822	HALIL		KIKA			
			823	KLEJDA		KIKA			
			824	LIRI		KIKA			
			825	LULEZIM		KIKA			
			826	SADETE		KIKA			
			827	SOKOL		KIKA			
			828	VERA		KIKA			
			829	VJOLLCA		KIKA			

Rrëfëhet këngëtari: Do jap maksimumin tim, pres energji pozitive nga publiku

Jessy Matador në Shqipëri për "Krishtlindje në Tiranë", emocionet e rikthimit

"E kam të thjeshtë të performoj live, ja kur del albumi i parë"

Egla Xhemali

Na ndajnë vetëm pak ditë larg magjisë që do të dhurojë spektakli i fundvitit "Krishtlindje në Tiranë". Dje në orët e para të mëngjesit mbërriti këngëtari me famë europiane Jessy Matador, i ftuari special i Sokol Gugës në eventin e përvitshëm që u jep edhe më shumë madhësi festave. Matador që do marri pjesë në këtë ngjarje artistike të kryeqytetit tregon ekskluzivisht për "Gazeta shqiptare" për ardhjen në Shqipëri, momentet më të bukura dhe më të sikletshme në skenë, performancat live, pritshmëritë që ka për spektaklin "Krishtlindje në Tiranë", si dhe projektet që ka në duar e surprizat që ka rezervuar për fansat në 2019. Artisti i famshëm pohon se ndihet i nderuar që do performojë në megaspektaklin e fundvitit si dhe pret të marrë energji pozitive nga publiku. Ai nuk i ka problem performancat live duke qenë se që i vogël e ka përjetuar magjinë e skenës si dhe ka qenë i apasionuar fort pas asaj që donte. 2011 e ka njohur me Shqipërinë, në veçanti me bregdetin ku dhe ka kënduar në klube. Është kënaqësi të rikthehesh përsëri thotë Jessy. Sa i përket momenteve të sikletshme në skenë ai ndan me ne eksperiencën që pati në Eurovizion, ku dhe, përfaqësonte Francën. Matador na zbulon gjithashtu, surprizën që do u bëjë fansave. Të gjithë ata që e duan muzikën e tij do kenë shumë shpejt albumin e gjigandit europian. E ndërsa dëgjon me vëmendje të ftuarin, producenti dhe regjisor i "Krishtlindje në Tiranë" premtori show natën e spektaklit dhe një sërë surprizash e të ftuar të tjerë. Spektakli do të mbahet më datë 18 tetor në sallën e madhe "Çesk Zadeja" dhe do të transmetohet në kanalën T-HD në DigitAlb. Do vij për ju një mbremje e mbushur me plot emocione dhe magji. Deri në prekje të kësaj nate ne i urojmë regjisorit dhe producentit Guga shumë suksese!

Jessy Matador në Shqipëri. **Pse ke ardhur?**
Jam këtu për shkak të ftësës së Sokol Gugës dhe ndihem mjaft i nderuar që do



të jem pjesë e spektaklit "Krishtlindje në Tiranë".
A kishe dëgjuar më parë për Tiranën? Si të duket?
Po, natyrisht që kisha



dëgjuar. Kam qenë në Shqipëri edhe më parë. Kam shkuar në Vlorë për të performuar në një nga klubet e natës në vitin 2011.

Momenti më i sikletshëm në skenë? Po më i bukur?

Momenti më i sikletshëm në skenë ka qenë kur përfaqësoja Francën në Eurovizion. Kisha emocione, aq shumë sa që nuk arrija të isha i sigurt se çfarë do të bëja.

Oferta më e çuditshme që ke marrë për të perfor-

muar?

Një ofertë e çuditshme ka qenë pas një koncerti, kur një burrë më ka kërkuar të kryej marrëdhënie me një femër, e cila e kishte kërkuar vet.

Si arrin një artist të këndojë "live" gjithë natën?

Unë e kam shumë të thjeshtë pasi kam filluar që i vogël me këtë punë. Është gjëja që dashuroj më tepër në këtë jetë dhe e bëj me shumë pasion.

Cilat janë pritshmëritë që ke për spektaklin

"Krishtlindje në Tiranë"?

Pritshmëria e vetme që kam është të pritem mirë nga publiku dhe të jap maksimumin tim. Gjithashtu, të marr energji pozitive edhe pse e di që nuk do të mungojë.

Projekti që ke momentalisht në duar? Kur do vijë për publikun?

Në vitin që vjen unë publikoj albumin tim të parë. Në janar del kënga e parë e këtij albumi. Bashkëpunime me këngëtare si Konshens Omar etj.



U konfirmua lidhja! Eni Koçi dhe Genc Prelvukaj janë bashkë

Ata kanë qenë shumë të përfolur për lidhjen e tyre, por asnjëherë nuk kanë folur rreth saj. Behet fjalë për Genc Prelvukaj dhe Eni Koçi, që tani janë çifti më simpatik i estradës shqiptare. Më në fund raporti i tyre u konfirmua, ku ishte Genci ai i cili doli dhe e pranoi lidhjen e tyre. E kjo ndodhi pikërisht, gjatë xhirimeve tek "Op Labi party 2019", ku ata u shfaqën që nga hyrja të kapur për dore. Aty u publike, për herë të parë, lidhjen mes tyre. "Kemi zgjedhë një event si ky, që të shfaqemi publikisht bashkë"- ka pohuar këngëtari. Tashmë, nuk ka vend për dyshime, sepse më në fund, e zyrtarizuan edhe këta lidhjen, e cila u përfol prej disa muajsh.



Ndryshim drastik! Tayna me foto me dhe pa make up

Është vullkani i këtij viti në muzikën shqipe. Reperja Tayna ka hyrë fuqishëm në këtë industri, duke sjell shumë këngë hite e duke u bërë nga më të komentuarat. Por, ajo nuk është përmendur vetëm për suksese e gjëra të mira. Së fundmi, Tayna në rrjetet sociale ka hedhur një fotografi ku fytyra e saj dukej me grim profesional dhe pa asnjë shenjë në fytyrë. Mirëpo, në një fotografi tjetër që ka hedhur një femër, fytyra e Taynës nuk ngjason fare me atë që e hodhi në foton e vetë. Po t'i shikoni këto fotografi, dallimi vërehet qartë.



Rozana Radi shkruan letër për Babagjyshin, ja çfarë kërkon këngëtarja

Këngëtarja Rozana Radi ka tërhequr vëmendjen e të gjithëve me një postim epik në rrjetin social 'Instagram', ku i ka shkruar një kartolinë babagjyshit. "I dashur Babagjysh! Ashtu si vitin që shkoj, edhe këtë vit dëshiroj të më sjellësh para. Dëshirën po ta nis të shkruar në letër zmerile, që të mos fshih bythën me kërkesën time, siç bëre vjet."- shkruan Rozana në foton që ka marrë qindra komente nga ndjekësit.



Nuk do ta besoni! Kallashi bëhet pjesë e ushtrisë së Kosovës

Kallashi vazhdon të jetë shumë e përfolur në publik. Dalja e saj në skenë shkaktoi shumë reagime, pasi kishte opinione pro dhe kundër. Kallashi ende është aktuale, ndonëse impakti i saj nuk është ai i dikurshmi. Ka shumë diskutime në lidhje me atë se ku është e çfarë po bën. Valltarja tërheqëse me rastin e formimit të ushtrisë së Kosovës, ka vënë në kokë kapelen me stemën e UÇK-së, e në gjoks mbanë një revole si aksesori. Imagjinoni sikur Kallashi të bëhej pjesë e Ushtrisë sonë. Epo, ushtarë si kjo vështirë se mund të ketë.



Kryeministri i zhgënjyer ndaj BE-së: Ndjehemi të tradhtuar ndaj jush

Taksa 100%, shfaqen tensione mes Haradinajt e Mogherinit

Kreu i qeverisë kosovare i kujton draft-marrëveshjen Europës

Ditën e djeshme pritej të kishte një konferencë të përbashkët mes delegacionit të Kosovës të udhëhequr nga kryeministri Ramush Haradinaj dhe atij të Bashkimit Evropian, i cili udhëhiqej nga Federica Mogherini, por në të vërtetë nuk pati asnjë të tillë. Ende nuk dihen arsyet e anulimit të kësaj konference. Në orarin e Komisionit Evropian ishte parashikuar që takimi të zhvillohej rreth orës 15:00. Pastaj është shtyrë për në orën 15:30 dhe më vonë, në faqen zyrtare nuk figuronte nëse do të zhvillohej kjo konferencë apo jo. Nga ana tjetër, burime të Radio Televizionit të Kosovës kanë konfirmuar anulimin e konferencës së përbashkët të Haradinajt me Mogherinin e Hahnin. Burime të pakonfirmuara kanë folur për tensione gjatë takimit dhe për këtë është bërë tarifa ndaj mallrave të Serbisë. Por ka patur një reagim nga ana e kryeministrit Haradinaj lidhur me kërkesën e BE-së dhe fjalës që do të shprehte në këtë konferencë.

FJALA E TIJ E PLOTË E HARADINAJT:

Të nderuar qytetarë,
Kjo është fjala ime e plotë në Këshillin e Tretë të Stabilizimit Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së, në Bruksel.
E nderuar Përfaqësues e Lartë Mogherini,

I nderuar z. Danielsson,
Të nderuar përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së,
Republika e Kosovës mirëpret Këshillin e Tretë të Stabilizimit Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së, me qëllim të rishikimit të progresit dhe sfidave në rrugën tonë europiane. Përkundër neglizhencës dhe mungesës së qartësisë për përkushtimin tonë europian nga ana e BE-së, Republika e Kosovës është fuqimisht e vendosur për anëtarësimin në BE si prioritet i lartë i saj, gjersa vazhdon të punojë pandërprerë



Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj dhe Federica Mogherini

për të arritur zbatimin e plotë të MSA-së, dhe të respektojë obligimet e kontratës sonë të përbashkët. Qëndroj këtu si kryeministër i një shteti sovran. Unë përfaqësoj popullin tim që ka vuajtur për besimin e tij në liri - dhe vazhdon të vuajë edhe sot. Me bindje të plotë mund të them se nuk ka vend në Europë më të përkushtuar ndaj idealeve të Bashkimit Evropian se sa Kosova. Vlerat tona janë vlerat e tuaja, shpresat tona për fëmijët tanë janë të njëjta me shpresat tuaja për fëmijët

tuaj. Kosova është shoqëri dinamike, që ka rini edhe më dinamike. Ata nuk i gëzojnë liritë që për ju janë normale. Ata nuk mund të udhëtojnë lirshëm, nuk mund të tregtojnë lirshëm dhe nuk mund të jenë pjesëmarrës të plotë dhe të barabartë në komunitetin e kombeve të lira. Përkundër këtij fakti fatkeq, ata thyejnë barrierat, edhe pa pasur viza, duke arritur rezultate të nivelit botëror në sport, muzikë, arsim, inovacion. Dhe kjo shumë lehtë

RAMUSH HARADINAJ:
"Edhe pse Kosova zbatoi të gjitha 95 kriteret e paracaktuara, siç është konfirmuar nga Komisioni në muajin maj, përgjigja që marrim nga BE, është gjysmake dhe e pashpresë. Edhe përkundër angazhimit të plotë në Agjendën e Reformës Europiane (ERA), dhe reformave të fuqishme të ndërmarra për të fuqizuar sundimin e ligjit dhe institucionet e tij, Kosova ndjehet e tradhtuar dhe e zhgënjyer nga BE", - shkruan ndër të tjera Haradinaj.

mund të ketë qenë arritje e Europës. Edhe pse Kosova zbatoi të gjitha 95 kriteret e paracaktuara, siç është konfirmuar nga Komisioni në muajin maj, përgjigja që marrim nga BE, është gjysmake dhe e pashpresë. Edhe përkundër angazhimit të plotë në Agjendën e Reformës Europiane (ERA), dhe reformave të fuqishme të ndërmarra për të fuqizuar sundimin e ligjit dhe institucionet e tij, Kosova ndjehet e tradhtuar dhe e zhgënjyer nga BE. Njerëzit tanë sprovohen përtë

asaj që është e arsyeshme dhe drejtë. Koha nuk është më e duhur të shohim progres konkret. Të nderuara shtete anëtare të BE-së, kjo është thirrja ime për ju: Duhet të përshtepojmë dhe konkretizojmë proceset e integritimit. Caku përfundimtar i rrugëtimit është i qartë - por ende, nuk është i prekshëm për ne. Kemi nevojë për një sinjal të qartë nga ju se i respektoni arritjet tona dhe se kemi mbështetjen tuaj, në mënyrë aktive, veçanërisht në realizimin e lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës. Qeveria dhe unë, asnjëherë, nuk e kemi vënë në pikëpyetje rëndësinë e dialogut. Kjo është e vetmja rrugë përpara për Kosovën dhe Serbinë, që të bëhemi anëtarë të barabartë të familjes europiane. Megjithatë, njëzet vjet pas luftës, dhjetë vjet pas pavarësisë, dhe pesë vjet pas Marrëveshjes së Brukselit, realiteti është se, përparimi drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka qenë minimal, dhe, në fakt, tani ka dalë krejtësisht nga binarët, veçanërisht me diskutimin publik mbi idenë fatale të korrigjimit të kufirit dhe shkëmbimit të territorit; ka dëmtuar seriozisht kredibilitetin e ndërmjetësuesit, dhe ka dëmtuar arritjet që kemi bërë në dialogun e ndërmjetësuar nga BE për më shumë se 7 vjet. Më lejoni të theksoj edhe një

herë, unë si kryeministër dhe qeveria e Kosovës, kundërshtojmë fuqishëm dhe e refuzojmë këtë ide, e cila do të sjellë vetëm luftëra dhe tragjedi të reja në Ballkan. Kushdo që flet për kufijtë, territorin, apo çfarëdo korrigjimi tjetër për vendim tim, është armiku ynë. Si kryeministër, ndodhem këtu për t'ju ballafaquar me të vërtetën, realitetin dhe orientimin e vendit tim, jo çfarë doni ju të bëjoni, ose për çka jeni njoftuar nga dikush tjetër. Realiteti është se ne jemi shtet sovran, demokratik dhe multi-etnik, dhe bazuar në këtë të vërtetë të padiskutueshme, ne duam të arrijmë një marrëveshje përfundimtare me Serbinë. Prandaj, si kryeministër, unë kam ecur përpara dhe kam paraqitur një draft Marrëveshje Gjithëpërfshirëse që e kemi parë, si hap fillestar drejt arritjes së një marrëveshje përfundimtare ligjërisht të obligueshme midis Kosovës dhe Serbisë, në mënyrë që të ecim përpara. Përveç kësaj, më 15 dhjetor Parlamenti i Kosovës votoi delegacionin e Kosovës për dialog. Delegacioni do të bashkëkryesohet nga Zëvendëskryeministri Limaj dhe kreu i Partisë Social Demokratike të partisë opozitare Shpend Ahmeti. Është delegacion gjithëpërfshirës me synimin që të përfshihen edhe palë të tjera. Ky është hap madhor në demokracinë tonë dhe i përgezoj të gjithë deputetët e Kosovës që votuan delegacionin. Marrëveshja përfundimtare synon të sjellë paqe afatgjatë dhe të sigurojë të ardhme prosperuese europiane për të dy shtetet. Përfshirja e Shteteve të Bashkuara në udhëheqjen e dialogut është kyç, përdërisa BE-ja ofron garanci, për të mbushur hendekun e mundshëm midis dy vendeve. Le të jemi të sigurtë, të hapur dhe të drejtëpërdrejtë në këtë mision. Të nderuara shtete anëtare, Jemi shumë mirënjohës për ndihmën tuaj përgjatë dekadave. Ju erdhjet për të na ndihmuar në kohë të vështira. Ju na ndihmuat të ndërtojmë atë që kemi sot. Por tani ka ardhur koha për të ecur përpara me vendosmëri dhe me shpejtësi - si partnerë. Dhe ne duhet të veprojmë tani! Ju faleminderit për organizimin e Këshillit të Tretë të MSA-së ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Kosova pret që në javët e muajt e ardhshëm të thellojmë dhe forcojmë marrëdhënien tonë kontraktuale.

Greqi/ Kërkonin ta rrafshonin, i vendosin 10 kg eksploziv televizionit

Hidhet në erë "Skai" në Athinë, policia dyshon për një sulm terrorist ndaj medias

Dje është njoftuar për një shpërthim me bombë në stacionin televiziv 'SKAI' në Greqi. Mediat greke raportojnë vetëm për dëme materiale në ndërtesë, nuk ka pasur asnjë të plagosur. Një shpërthim i fortë me bombe ka ndodhur në 02.37 me orën lokale në stacionin televiziv SKAI në Faliro, në Athinë. Para shpërthimit në 01.45, një person i panjohur ka telefonuar në stacionin televiziv ANT1 dhe ka folur në diferencë prej 45 minuta, tri herë duke thënë se "kjo nuk është një farsë". Thirrja me telefon është bërë nga person i panjohur nga një "pakistanez Phone". I njëjti njoftim, siç është bërë në thirrjen për vendosjen e një mjeti shpërthyes jash-



të shtëpisë e Zëvendës Prokurorit Isidoros Ntogiakou në nëntor. Burimet e policisë thonë për një shpërthim shumë të fortë me

vlerësimet e para që përbëjnë më shumë se 5 kilogramë eksplozivë. Sipas të njëjtit informacion, të panjohurit që iu afruan pikave me motor kishin vënë bombën në një thes. Shpërthimi ka qenë aq i fuqishëm sa dëmi material ka shkuar deri në katin e pestë të ndërtesës. Agjencia e Lajmeve të Athinës tha se pajisja shpërthyes ishte vendosur jashtë ndërtesës - më konkretisht, në trotuar përballë hyrjes së objektit, rreth shtatë metra larg. Policia, gjithashtu, dyshon se duhet të ketë qenë një grup me skenar të mundshëm, ata që e kanë vënë bombën. Zgjedh-

ja e pikës pa kamera, tregon, sipas burimeve të policisë, se bombarduesit e kanë studiuar mirë zonën në mënyrë që të mos regjistrojnë lëvizjet e tyre. "Ata donin të rrafshonin ndërtesën", - shprehet policia. Shpërthimi u ndje shumë qindra metra nga ndërtesa 'SKAI', duke shkaktuar shqetësim për banorët e zonave përreth. Policia e trafikut ka ndaluar qarkullimin e automjeteve. Ndërkaq të tjera detaje zbulohen për shpërthimin që ndodhi në televizionin 'Skai' në Athinë. Dyshohet se në shpërthim janë përdorur 10 kg eksploziv përzier me amoniak dhe TNT për të rritur

shpejtësinë dhe forcën e bombës. Deri në katin e gjashtë të ndërtesës është dëmi i shkakuar nga shpërthimi i fuqishëm. Autoritetet po e konsiderojnë aktin si sulm terrorist. Sipas policisë greke në këtë rast kemi të bëjmë me persona shumë profesionale. Autorët ende të paidentifikuar kanë dashur ta bëjnë rrafsh me tokën ndërtesën e 'Skai'. Agjencia e Lajmeve të Athinës tha se pajisja shpërthyes ishte vendosur jashtë ndërtesës, më konkretisht në trotuar përballë hyrjes së objektit, rreth shtatë metra larg. Para shpërthimit në 01.45, një person i panjohur ka telefonuar në stacionin televiziv ANT1 dhe ka njoftuar se është vendosur bombë tek TV 'Skai', i cili njihet për qëndrimet kritike ndaj qeverisë Cipras.

Francë, kryeministri Philippe: Defiçiti buxhetor është në rritje

Emmanuel Macron, anulon vizitën për G7 e njofton fillimin e dialogut me jelekverdhët

Ditën e djeshme presi dentë francez Emmanuel Macron ka njoftuar fillimin e debatit të madh publik, të promovuar në përgjigje të protestës së jelekverdhëve, theksuan burime pranë Elysee. "Macron ka anuluar vizitën e së martës në Biarritz, ku ai duhej të diskutonte samitin e G7-ës, që Franca do të presë vitin e ardhshëm, në mënyrë që të zhvillojë bisedime me ministrat lidhur me debatin publik", theksuan burimet pranë Macron. Ndërkohë,

BURIME PRANË PRESIDENCËS:

"Macron ka anuluar vizitën e së martës në Biarritz, ku ai duhej të diskutonte samitin e G7-ës, që Franca do të presë vitin e ardhshëm, në mënyrë që të zhvillojë bisedime me ministrat lidhur me debatin publik", theksuan burimet pranë Macron.

EDOUARD PHELIPPE:

"Defiçiti buxhetor i Francës në vitin 2019 ishte 3,2 % të PBB-së, pra mbi maksimumin zyrtar të BE-së prej 3%", theksoi kryeministri francez Edouard Philippe.



kryeministri Edouard Philippe konfirmoi ditën e diel se kostoja totale e koncesioneve do të ishte rreth 10 miliardë euro. Philippe i tha gazetës së biznesit "Les Echos" se një seri masash taksash dhe shpenzimesh publike do të kompensonin në rreth 4,1 miliardë euro. "Defiçiti buxhetor i Francës në vitin 2019 ishte 3,2 % të PBB-së, pra mbi maksimumin zyrtar të BE-së prej 3%", theksoi kryeministri Philippe.

Afati deri në 19 dhjetor, kryeministria dështoi të bindë BE për rinegociim të Brexit

Theresa May kundër referendumit të dytë në Britani

Kreu i qeverisë Britanike: Kjo është një tradhti ndaj popullit

Ditën e djeshme kryeministria britanike, Theresa May ka dalë publikisht kundër një referendumi të dytë për çështjen Brexit. Shefja e qeverisë së Londrës e konsideron tradhti ndaj popullit britanik, ndërmarrjen e një nisme të tillë. Sipas saj, britanikët e shprehën vullnetin e tyre për të dalë nga unioni në referendumin e dy viteve më parë. Por ish-kryeministria Toni Blair e John Major i kanë bërë thirrje May-t të tërhiqet nga dalja nga Bashkimi Europian dhe për këtë të marrë mendimin e popullit në një referendum të dytë. Kryeministria britanike do të flasë në parlament për përpjekjet e dështuara në Bruksel për të rinegociuar marrëveshjen, që kundërshtohet nga një pjesë e konservatorëve. Ndërkaq, nga ana tjetër, qeveria britanike po përgatitet prej kohësh fshehurazi për një referendum të dytë për Britaninë. Të përditshme prestigjioze britanike si "Sunday Times" dhe "Mail Sunday" citojnë burime pranë qeverisë që thonë se numri dy i qeverisë David Lidington dhe shefi i kabinetit të kryeministres Gavin Barwell kanë zhvilluar takime me dyer të mbyllura gjatë orëve të fundit me ministrat. Referendumi i dytë për Britaninë shihet si një ndër mundësitë më të mira që qeveria të tërhiqet nga vendimi për daljen nga Bashkimi Europian, pasi marrëveshja e arritur me Bruksel ka pak gjasa të miratohet në parlament, duke rrezikuar atë që është quajtur si katastrofë financiare për vendin. Theresa May e ka mohuar



Kryeministria e Britanisë së madhe Theresa May

THIRRJA E BLAIR DHE MAJOR

Ish-kryeministria Toni Blair e John Major i kanë bërë thirrje May-t të tërhiqet nga dalja nga Bashkimi Europian dhe për këtë të marrë mendimin e popullit në një referendum të dytë. Kryeministria britanike do të flasë në parlament për përpjekjet e dështuara në Bruksel për të rinegociuar marrëveshjen, që kundërshtohet nga një pjesë e konservatorëve.

publikisht mundësinë e referendumit dhe reagoi ashpër ndaj të njëjtës thirrje të ish-Kryeministrit

Toni Blair: "Po luftoj për një marrëveshje të mirë për Britaninë dhe do të vazhdojë ta bëj. Por dua t'i

them Tony Blair që shkon në Bruksel dhe përpiqet të minojë negociatat tona duke mbështetur referendumin e dytë, se është fyerje për postin që ka mbajtur dhe për njerëzit të cilëve u shërbeu". Të premtën, ish-Kryeministri Blair kërkoi publikisht t'i jepet fund përpjekjeve për daljen nga Bashkimi Europian dhe të organizohet një referendum i dytë, duke shprehur besimin se rezultati do të jetë i kundërt nga ai i 2016-ës ku rreth 52% e votuesve mbështetën daljen e Britanisë nga unioni. Bashkimi Europian ngriti një mur përballë kërkesave të kryeminstres britanike Theresa

May, për rinegociim të marrëveshjes për Brexit. Presidentët e Këshillit dhe Komisionit, Tusk e Juncker, u treguan të prerë më Londrën duke nënvizuar se rrugë për kushte të reja nuk ka. Kryeministria May ka kohë deri më 19 Dhjetor për të qartësuar pozicionin e saj, tha Juncker, më pas BE do të publikojë përgatitjet për një skenar pa Brexit, çka do të ndërlikonte më tepër pozitat e shefes së qeverisë dhe vetë Britanisë së Madhe. Pasi mori votëbesimin e deputetëve të saj May, u përpoq të bindë edhe Brukselin për kushte të reja për kufirin me Irlandën, çka me gjasa do të jetë e pamundur.

SHKURT

Fëmija që lindi sa ora e të atit ndërrohet jetë

Një fëmijë i lindur para Nkohe, në madhësinë e orës së të atit, 24 javë më parë, ka ndërruar jetë tragjikisht në krahët e së ëmës. Lorcan Michael O'Brien lindi me peshë 705 gramë më 13 maj të këtij viti në Spitalin e Fëmijëve në Perth të Australisë dhe u diagnostikua me një sëmundje kronike në mushkëri. Mjekët vazhdimisht u përsëritën prindërve Nikki Daly dhe Ruairi O'Brien se fëmija i tyre i porsalindur nuk do të arrinte të mbijetonte. Por përkundër të gjithë parashikimeve të mjekëve, i vogli arriti të jetonte deri në muajin dhjetor. Ai tragjikisht ndërroi jetë teksa përkundej në krahët e së ëmës.

Ministri turk: Trump premtoi ekstradimin e Gulenit

Shtetet e Bashkuara po shqyrtojnë mundësinë e ekstradimit të klerikut Fetullah Gulen drejt Turqisë. Këtë e pohoi ministri i Jashtëm turk, Mevlut Çavusoglu, i cili thotë se premtimin Ankarasë, ia ka bërë vetë Presidenti amerikan Donald Trump. "Ky njeri dhe të tjerë anëtarë të kësaj organizate - janë 84 emra - duhet të ekstradohen në Turqi. U kemi dërguar kërkesë autoriteteve amerikane. Herën e fundit kur u takuam në Buenos Aires, Presidenti Trump i tha Erdoganit se po punojnë për çështjen e ekstradimit". Kryediplomati turk pohoi se FBI ka nisur hetimet për rrjetin e Gulenit në Shtetet e Bashkuara, pasi ka dyshime se ata janë të përfshirë në afëra korruptive e evazion fiskal. Megjithatë shefi i Shtëpisë së Bardhë është shprehur qartë muajin e kaluar se nuk ishte duke shqyrtuar ekstradimin e Gulenit drejt Turqisë. Ankaraja e akuzon klerikun se me ndihmën e grupeve të financuara prej tij, organizoi grushtin e dështuar të shtetit të korrikut 2016.

Irak, rindërtohet xhamia ikonë që u shkatërrua nga IS-i

Një udhëheqës fetar i Irakut vuri duror themelin për rindërtimin e Xhamisë së Madhe të Mosulit Al-Nuri, e cila është rrënuar nga militantët e grupit Shteti Islamik (IS). Abdul Latif al-Humaymit iu bashkuan në ceremoni edhe personalitetet e Kombeve të Bashkuara dhe të Bashkimit Evropian. Xhamia, minarja e pjerrtë e së cilës ka qenë një nga monumentet më të famshme të Mosulit, është vendi ku udhëheqësi i Shtetit Islamik, Abu Bakr al-Baghdadi, ka shpallur "kalifatit" në vitin 2014. Grupi xhihadist e ka hedhur atë në erë vitin e kaluar, derisa forcat qeveritare kanë rimarrë kontrollon e Mosulit. Beteja për Mosulin ka zgjatur pothuajse nëntë muaj, ka lënë zona të mëdha të shkatërruara, ka vrarë mijëra civilë dhe ka zhvendosur më shumë se 900.000 të tjerë.

EKSPOZITA



LEK GJELOSHI:

Imazhe të veshura në mister dhe procesi i rikrijimit

Fatmira Nikolli

Murgësia të errëta që ecin në borë, njerëz që i sillen një krateri apokaliptik, procesione, fëmijë e trupa që amplifikojnë gjeiste mistike. Fillova t'i fotografoj me celular - mjetin e vetëm që kisha në dispozicion në atë moment. Mirëpo nevoja për t'i poseduar disi këto imazhe, filloi ta shtonte kuriozitetin për t'i parë si fotografi". Lek Gjeloshi ka çelur të premtën e shkuar në Galerinë "Zeta" ekspozitën "N'jerm". Për të titulli erdhi shumë thjesht. Kur pyetet se ç'është 'jermi' i tij, përgjumbje, përumbje, mjegull a amulli, ai përgjigjet: "Të gjitha janë sfumatura të fjalës. Si titull i ekspozitës, kontributi është i nënës sime, e cila sapa pa imazhet e para të serisë, i sigloi kështu: n'jerm".

Ndonëse nuk dihet autori i fotove apo vendi ku janë shkrepur, ato kanë një finesë inskenimi e kompozimi. Referencat që mund të gjejmë në to kalojnë nga piktura dhe afresku, deri në skena kinematografike horrori. E gjitha në një atmosferë mesjetare, pra edhe të errët, për të cilën kultivoh një interes të thellë.

Ajo paraqet një cikël me fotografi të shkëputura nga një grumbull negativësh me të cilët autori ndeshet rastësisht, nisur si pretekst për të testuar me to një makineri të vjetër për zmadhimin e filmave 35mm. Imazhet e seleksionuara përmes saj janë fragmente të organizuara pa një rend të paraktuar narrativ. I tërhequr nga dimensionit fantazmagorik i subjekteve mbi sipërfaqen e ekranit, ai fillon t'i fotografojë duke aktivizuar gradualisht një jetë të dyfishtë të imazheve, ku pjesë e tyre është tashmë edhe dritë e ekranit të projektorit, gjurmë e vjetërsisë



"N'jerm", ekspozita që zbulon një arkiv të panjohur në një dritë të re

dhe reflektet që ndodhen në sipërfaqen e tij. Këto fotografi i inverton më pas në negativ dixhital, duke përdorur opsionin e zakonshëm që ofron aplikacioni i celularit. Nga kjo mbivendosje negativësh, procesi algoritmik i thjeshtë prej ku ai përfiton imazhe, "pozitivët" hibrid, të cilat ngarkohen me një atmosferë të re që nuk referon më informacionin e fotografisë e as dëshminë e saj, por devijimin konstant, një soj kllapie ose përcartjeje të asaj që mbetet mbi sipërfaqen e mbështjellë nga tisi i blucianit.

- Çfarë janë këto fotografi, që kanë shërbyer si bazë e ekspozitës "N'jerm"?

Gjithçka fillon nga takimi me një makineri të vjetër, që dikur shërbente për zmadhimin e negativëve 35mm. Një shok më ofroi një grumbull me filma fotografik, me të cilët fillova ta testoj. Materialet që po merrja në dorë ishin të mveshura me një soj misteri, për sa kohë nuk kisha të dhëna e as informacione për to. Unë kam studiuar pikturë që i vogël. Ndoshta

ishte kjo arsyeja eJoshjes që provoja, ndërkohë që subjekte e pelzazhe më shfaqeshin para ekranit në trajta të paqarta e fantazmagorike. Murgësia të errëta që ecin në borë, njerëz që i sillen një krateri apokaliptik, procesione, fëmijë e trupa që amplifikojnë gjeiste mistike. Fillova t'i fotografoj me celular - mjetin e vetëm që kisha në dispozicion në atë moment. Mirëpo nevoja për t'i poseduar disi këto imazhe, filloi ta shtonte kuriozitetin për t'i parë si fotografi. Pa e stërthulluar procesin dhe duke djegur shumë etapa teknike të zhvillimit të fotografive, nisa t'i invertoj me aplikacionin e zakonshëm të telefonit, duke aplikuar mbi to një filtër negativ. Mbivendosja e negativit mbi imazhe që kishin dokumentuar gjithësi negativë, solli në dritë një seri me pozitiva hibrid, krejtësisht të mveshura nga kromatika e blucianit. Nga njëra anë ky proces i devijoi prej informacioneve konkrete që ato fotografi do të kishin nëse të zhvilluara në një rrugë konvencionale. Nga ana tjetër i ngarkoi me një

atmosferë të re, duke e bërë edhe më ekstreme gjendjen dhe natyrën eterike të subjekteve. Këtu hibridizohet edhe çështja e autorësisë...

- A keni zhbërë të kaluarën e fotove për t'iu dhënë një jetë të re, një identitet të ri?

Materialet e një arkivi kanë tendencën t'i nënshtrohen një horizonti, ku gradualisht zvogëlohet freskia e të papërcaktueshmes - mbasi kanë nevojë të sistemoen e të datohen. Ajo që më intereson në këtë rast, në raport me idenë e ndërhyrjes mbi një arkiv si ky, është dalja prej tij. Një soj çlirim i çregullimi i imazheve, që përbën aventurën e tyre sot. Kjo aventurë është mënyra se si ia dorëzoi teknologjisë. Ndërsa tjetërsimi, duke na vënë përballë kualitetit të perceptimit më shumë se sa të krijimit, nuk është më shprehë e vullnetit arbitrar, por epifania para të cilës unë vetë asistoj.

- Çfarë është "jermi" juaj? Përgjumbje, përumbje, mjegull, amulli?

Të gjitha janë sfumatura të fjalës. Si titull i ekspozitës, kontributi është i nënës sime e cila sapa pa imazhet e para të serisë, i sigloi kështu: n'jerm.

- A jemi ne, qenia njerëzore, një mbivendosje negativësh e pozitivësh në unën tonë?

Nuk e di. Por edhe në qoftë se do të ishte kështu, mbivendosja si diçka e "efektshme" nuk mund të garantojë gjithmonë rezultate të konsiderueshme. Kjo vlen për çdo sipërfaqe të brishtë: qoftë unë, imazhi apo deliri mbi njërin ose tjetrin.

- Në të na shfaqen trupa, rite liturgjike e pelzazhe të vagullta, ekzistenca herë të magjepsura, herë të mbetura pezull në një fshat të mistershëm diku në Shqipërinë veriore; si rikrijohen të gjitha këto?

Me siguri imazhet janë dokumentime momentesh të veçanta, sic

duket të kenë qenë ritet fetare pas viteve '90. Në to dallohet devocioni i njerëzve për të qenë pjesë e ngjarjes. E shohim të veshjet, të rigoroziteti me të cilin ekzaltojnë gjetet. Rikrijimi, përveç asaj që thashë më lart, ka të bëjë edhe me seleksionimin dhe dramaturgjinë që ofrojnë si pjesë e një serie fotografike. Secila ka potencialitetin për t'i shkëputur marrëdhëniet konkrete me realitetin që i ka krijuar. Pikërisht tek ky sfazim gjej edhe hapësirën për të provokuar distancën mes tyre dhe publikut, në momentin që marr përsipër t'i ekspozoj.

- Pse rite liturgjike?

Të tilla janë ngjarjet që ato paraqesin. Në pjesën më të madhe perceptohet koha e Rrshajëve, e krezmimeve. Procesionet e Krezh-mëve, si ditë pendese e lutjeje që i paraprijnë Pashkëve. Jo pa interes, në këtë rast, më duket reflektimi që bën mbi liturgjinë Giorgio Agamben në "Opus Dei", duke e parë etimologjinë e saj si "leitourgia" (nga "laos", popull, dhe "ergon", veprë) pra në kuptimin e një "vepre publike".

- Cili është fshati i mister-shëm?

Nuk është shumë e qartë. Ajo që di është se ndodhet diku mes Shkodrës dhe Lezhës.

- Pse arkiv i panjohur e pa autorësi?

I panjohur sepse flet për ekzistencën e një komuniteti për të cilin nuk dimë diçka. Pa autorësi, sepse nuk dimë nëse këto fotografi janë fruit i vetë komunitetit apo i një autori. Fakt është që imazhet, përtej tendencës së dokumentimit, kanë një finesë inskenimi e kompozimi. Referencat që mund të gjejmë në to kalojnë nga piktura dhe afresku deri në skena kinematografike horrori. E gjitha në një atmosferë mesjetare, pra edhe të errët, për të cilën kultivoh një interes të thellë.

BOTIMI

"NALTËSIMI I ISKANDERIT"

Kur ish-kryeministri i Britanisë shkruante për Gjergj Kastriotin

Libri "Naltësimi i Iskanderit" shkruar prej ish-kryeministrit të njohur Britanik Benjamin Disraeli dhe sjellë në gjuhën shqipe nga Mal Berisha u promovua dje në Tiranë, mes studiuesish, diplomatësh dhe dashamirës. Mendohet se Disraeli mund të jetë njohur me emrin e Skënderbeut dhe veprën e tij kur ishte i ri dhe bënte një tur në Mesdhe në vitin 1830. Duhet të ketë qenë ky tur që la kujtime të pashyera në tërë jetën e tij të mëvonshme, pasi ai nga Korfuzi ai udhëtoi në Artë dhe në Janinë e prej aty i shkroi letra familjes dhe të atit, të cilat janë studiuar dhe botuar me vëmendje të posaçme nga dr. Robert Elsie.

Libri është përkthyer nga gjuha angleze dhe shoqërohet me një analizë kritike, historike dhe letrare nga studiuesi dhe ish-diplomati, Mal Berisha. Për këtë botim, ai mori çmimin e përkthyesit më të mirë në Panairin e 20-të librit në Prishtinë këtë vit. Novela, ka trille letrare e mbështetur mbi fakte dhe figura historike që ka si personazh kryesor Heroin tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu. Benjamin Disraeli cilësohet shkrimtar dhe politikan i rrallë, dy herë Kryeministër i Britanisë së Madhe. Përveç karrierës së tij politike rënditë midis njerëzve më të shquar për faktin se nga një njeri i elitës intelektuale u bë një drejtues i jashtëzakonshëm shteti. Midis afro 20 veprave tjera letrare, "Naltësimi i Iskanderit" e vendos atë në radhën e shkrimtarëve më të shquar të periudhës së romantizmit viktorian në botën e letrave angleze.

LIBRI

Për të folur mbi librin ishte një panel i zgjedhur, i përbërë nga Dr. Dorian Koçi, Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, Profesor Bardhyl Musai-Botues, Mal Berisha-Përkthyes i veprës "Naltësimi i Iskanderit" studiues, ish-ambasador.

Të pranishmit shprehën vlerësimet, mbresat dhe përshtypjet e tyre mbi librin "The Rise of Iskander" botuar në vitin 1833 nga Benjamin Disraeli, i cili përveç karrierës së tij në politikë rënditë ndër njerëzit e shquar, edhe për faktin se nga një njeri i elitës intelektuale u kthye në drejtues shteti. Novela "Naltësimi i Iskanderit" është shkruar në një kontekst historik kur shqiptarët po fillonin zgjimin e tyre kombëtar dhe figura e Iskanderit ishte pishitari ndriçues në udhën e nisur.

Më herët, Mal Berisha ka thënë se vlerësimi për veprën "Naltësimi i Iskanderit" nuk do të ishte i plotë pa njohjen e autorit të saj, pasi këtu qëndron edhe rëndësia e madhe e saj. Benjamin Disraeli,



Libri i vitit 1833 promovohet në Tiranë, Koçi: Aktuale për lexuesin shqiptar

Earli i Beaconsfield-it, (1804-1881) ka qenë shkrimtar i njohur anglez, autor i më shumë librave dhe shumë traktateve e letrave politike, si dhe një politikan konservator britanik. Ai ka qenë dy herë Kryeministër i Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe (shkurt - dhjetor 1868 dhe 1874-1880), i vetmi pasardhës i një familje hebraike, ndonëse i konvertuar në të krishterë, i ngjitur deri në atë post të lartë, në tërë historinë e atij vendi.

"Novela "Naltësimi i Iskanderit" është pikësepari një veprë letrare. Natyra e saj është thellë-

sisht romantike dhe nuk kishte sesi të ishte ndryshe pasi në kohën e botimit, Europa ishte në kulmin e lulëzimit të romantizmit si rrymë letrare si edhe në muzikë, pikturë dhe në jetën intelektuale, ndjenjat e njeriut, imagjinatën dhe mjeshhtërinë artistike të autorëve", shprehet Berisha. Sipas tij, një tjetër arsye që ka ndikuar tek Disraeli që të shkruajë këtë veprë ishte fakti që në kulturën viktoriane, helenizmi ose klasicizmi grek ka të bëjë me mitizimin e një fenomeni apo të një figure historike, apo edhe vetë shndërrimin e tyre nga plani i të vërtetës historike në një



plan të përjetësisë universale mitologjike. "Ky është pra naltësimi, naltësimi nga realiteti, nga historia deri në mit. Naltësimi që vjen nga helenizimi viktorian i kulturës angleze prej nga del edhe Heroi ynë Kombëtar, Skënderbeu, i kthyer në një personazh, të cilin autori, e quan Iskander", vërente Berisha.

"I shtrenjti im baba! I shkrova Ralfit nga Malta ndërsa juve nga Korfuzi... Të përmenda në letër se kishte një mundësi që t'i bëja vizitë Vezirit të Madh në vëndndodhjen e tij në Janinë, kryeqyteti i Shqipërisë... Mëngjesin tjetër bëme një vizitë tek guvernatori Kalo Bej, i cili njëherë e një kohë kishte qenë më i pasuri i vëndit ndërsa tani njëri prej fisnikëve më të fuqishëm shqiptar..."

Kostumet shqiptare, janë pambarrimshëm të larmishme në kombinacionet e tyre" i shkruante Disraeli të atit.

Në fjalën e tij dje, drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr.Dorian Koçi, u shpreh se: "Autori përshkruan takimin e Skënderbeut me Huniadin dhe marrëveshjen që ata bënë për të mbrojtur krishtërimin; marrja e fermanit nga mëkëmbësi i sultanit dhe përdorimi si dokument para guvernatorit turk të Krutës për lëshimin e qytetit pa luftë etj. Të gjitha këto elemente e bëjnë novelën e Benjamin Disraelit shumë aktuale për lexuesin shqiptar, duke menduar se vepra është shkruar në vitin 1833 dhe shkrimtari e dinte aq mirë historinë e lavdishme të Skënderbeut".

PREZANTOHET LABORATORI I RI QENDROR I RESTAURIMIT

mi i dokumenteve na bën bashkë me një marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës për të ruajtur historinë tonë duke i shpëtuar dokumentet nëpërmjet meto-

dave të reja të modernizuara me mjetet dhe teknologjinë e përdorur për restaurim, ku ka siguruar fondet e domosdoshme (nga buxheti i shtetit) për të kryer investime në këtë Labo-

rator. Ky investim për pajisjet dhe mjetet e punës më bashkëkohore, dhe mbi të gjitha në trajnimin e punonjësve në laboratorët më të mirë të huaj, mundëson hapjen e rrugës që çdo dokument i historisë kombëtare, qoftë në Shqipëri, në trunqun kombëtar a në diasporë" -tha Bido.

Kryeshefi i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës Ram Manaj e cilësoi restaurimin e dokumenteve si e ardhmja e Arkivit dhe ndihmesë për studiuesit si pjesë e ruajtjes së dokumentacionit.

Në fund të prezantimit përgjegjësjë e sektorit të Restaurimit shpjegoi proceset që kalon një dokument gjatë fazës së restaurimit.



Opinion *i* Ditës

Rama po kërkon kamerdaren e Monës dhe Lulit

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... të paguanin edhe për ngelësit. Më pas, kur pa përmasat që morën manifestimet, ai luajti rolin e njërit prej tyre. Ai arriti kulmin duke thënë në "Opinion" se studentët në rrugë kishin dalë për dashurinë ndaj tij, madje ëndërroi si gardistët e kuq të kryetarit Mao që do të marshonin bashkë më tej për të linçuar rektorët, dekanët dhe pedagogët.

Tani kur protesta ka mbërritur në ditën e saj të 13, ai u kthye të bëjë atë që di të bëjë më mirë.

Atë që ka bërë pothuajse me çdo manifestim kundër tij, që prej kohës së armëve kimike.

Me delirin e atij që nuk pranon asnjë defekt, ai do ta shesë atë që ndodhi si një manipulim të opozitës që nuk e mund dot Rilindjen me vota.

Po t'i shohësh statuset e Ramës të ditëve të fundit, ato janë të mbushura me alegori për PD dhe LSI.

Ato u fryjnë borive të kapjes së protestës nga partitë, të forumeve rinore që kanë zënë vendet e studentëve të çiltër dhe të militantëve që luajnë rolin e prindërve realë.

Në këtë fazë të tretë të ndryshimit të strategjisë së tij, kryeministri nuk i ka mbetur asnjë rrugëgjydhje tjetër, veçse të për-



dorë Monën dhe Lulin si kamerdare shpëtimi.

Natyrisht, opozita ka luajtur rolin e saj të shëmtuar në të gjithë këtë histori. Por këtu në

pyetje nuk është qëndrimi i saj, por shndërrimi, i atij që kërkoi të luante rolin e timonierit të madh, në një politikan meskin që godet pas shpine.

Dhe kjo e ka një shpjegim fare të thjeshtë. Ai duhet kërkuar tek fakti se ata studentë refuzojnë ta shohin si partner në dialog.

Për disa arsye.

Sepse ai, që tashmë ka marrë etiketën kryeministri i të pasurve, nuk shihet më si një shpresë për shoqërinë e drejtë dhe të barabartë, ku ata duan të hyjnë nesër.

Sepse ai, si nismëtari i ligjit të arsimit të lartë që planifikon të çojë paratë publike tek privatët, nuk ka asnjë shans që në afatgjatë të plotësojë kërkesat e tyre.

Sepse ai që e ka mbushur qeverinë dhe administratën me hajdutë të pagdhendur me diploma false, nuk është në gjendje t'u përgjigjet aspiratave të tyre.

Sepse ai, pas manipulimeve me FRESH-in dhe spektaklit fals që organizoi në "Top Show", tregoi se është i një race të ndryshme me ata studentë, që ende nuk janë mësuar me makiavelizmin e ballarëve të tyre.

Sepse ai, edhe kulturalisht edhe estetikisht tregoi se është ku e ku më i vjetër se shpërthimi i kreativitetit dhe fantazisë që shpalosën këto ditë studentët.

Këto dy javë treguan se edhe nëse do e kishte të mundur, ai kurrë nuk do të arrinte të ishte partneri, dialogues apo bashkudhëtar i tyre.

Dhe me sa duket e ka kuptuar këtë.

Prandaj i është shmangur përballjes reale dhe po përpiqet ta zhvendosë konfliktin me Lulin dhe Monikën. Sepse vetëm aty ndihet mirë, me të singjashmit e vet.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion *i* Ditës

Protesta e të rinjve studentorë, një energji pozitive për vendin

Nga Miron Çako

(vijon nga faqja 1)

... të thotë të kesh vetëm një trup vital plot energji jetike, por të kesh një ndërgjegje të pastër, plot energji intelektuale, me guxim vizionar për ndërtimin e shoqërisë dhe në të mirë të vendit, ashtu si thekson Benjamin Disraeli (1804 - 1881): "Të rinjtë e një kombi janë kujdestarët e brezave të ardhshëm".

Protesta e të rinjve studentorë, e mbështetur edhe nga gjimnazistët jo vetëm në kryeqytet, por edhe në qytetet e tjera, duhet parë me optimizëm si një energji pozitive, si antikorp i shfaqur natyralisht në trupin e shoqërisë sonë, për të shëndosur pjesën e saj të sëmurë nga infeksioni, i amoralitetit, papërgjeshmërisë, abuzimit dhe padrejtësisë, që bëjnë të rriturit, të cilët për shkak të shtresës së gabimeve të tyre, e kanë trashur ndërgjegjen edhe nuk kuptojnë se po gabojnë jo vetëm ndaj vetes, por edhe ndaj të ardhmes së fëmijëve të tyre.

Protesta e të rinjve, e cila po përshkallëzohet çdo ditë e më shumë, duke kërkuar nga qeveria zbatimin e kërkesave të tyre për ulje tarifash, kushte më të mira në shkollë, konvikte dhe pjesëmarrje në vendimmarrje për problemet e arsimit në universitete, pavarësisht tensionit që ajo shfaq, ajo është një tregues shumë pozitiv dhe optimiste, që rinia shqiptare pavarësisht kushteve të vështira ekonomike, sociale, që po përballon me gjithë pjesën tjetër të shoqërisë, është një rini me një aspiratë të lartë intelektuale, për një arsimim më cilësor dhe meritokraci.

Kjo protestë tregon se nesër këta të rinj duan të jenë shtetas sa më të përgatitur dhe të përgjegjshëm për të mirën e Shqipërisë, vendit tonë, që geografikisht është në kërthizë të Europës.

Protesta e të rinjve duhet të na japë gëzim dhe shpresë të madhe të gjithë si popull, sepse me këtë



rini, me të tilla aspirata arsimdashëse, ky vend me një tranzicion të stërgjatur mund të bëhet një ditë të shpejtë si gjithë Europa.

Vetëm në qoftë se të rinjtë do të ishin pasivë në situatën ku ndodhet arsimi dhe mësimdhënia sot, atëherë duhet të shqetësoheshim dhe të trembeshim, sepse një rini që nuk interesohet për arsimin e saj është një qelizë e vdekur e shoqërisë dhe pa shpresë për të ardhmen, ashtu si thekson dhe tragjediani grek, Euripidi, (480 - 406 pr.K):

"Kush neglizhon të mësuarit në rininë e tij, humbet të kaluarën dhe është i vdekur për të ardhmen".

Prandaj mendoj se protesta e të rinjve studentorë duhet mbështetur nga i gjithë populli, pedagogët, partitë politike dhe aktorët vendimmarrës, jo për t'i marrë me të mira që të ulin vullmin e protestës, ose më keq për t'i përdorur si mësh për top që të rriturit të shkarkojnë mlllefet kundër kundërshtarit, apo për të përfutur kredibilitet poli-

tik dhe rotacion pushteti, por që të gjithë të rriturit e përgjegjshëm të këtij vendi të mblidhen sa më shpejt, që të zgjidhet me më mirën e mundshme kjo situatë kolapsi e arsimit të lartë, për të mirën e arsimimit të të rinjve studentë, një çështje me rëndësi të madhe kombëtare, jo vetëm për të ardhmen, por edhe për të tashmen e vendit, ashtu si thotë edhe kryepiskopi i K.O.A.SH- it imzot Anastasi, se: "Rinia nuk është vetëm e ardhmja, por edhe tashmja".

HOROSKOPI

DASHI

Gjatë ditës së sotme do të mendoni për suksesin që keni arritur deri më tani si në jetën personale, ashtu edhe në atë profesionale. Megjithatë, është e rëndësishme që të mbani veten nën kontroll dhe tregohuni optimist, pasi vetëm kështu mund të shkoni në drejtimin e duhur.

DEMI

Mund të përballeni me disa propozime tunduese për biznes. Zgjidhni ato që kanë më shumë prioritet për ju, por mos harroni as detajet më të vogla. Ka gjasa të nisni edhe një punë të re, por sigurohuni që të mos ju shkaktojë stres.

BINJAKET

Do të përballeni me mundësi të reja profesionale, pasi në punën tuaj mund të hapet një degë e re. Sa i përket anës romantike, do tju ndjekë fati në çdo moment. Bëqarët e kësaj shenje mund të takohen me një person shumë interesant.

GAFORJA

Ka gjasa të organizoni një festë të vogël me njerëzit më të afërt, ku do të kënaqeni pafund edhe me detajet më të vogla. Rekomandohet t'i kushtoni shumë vëmendje familjes. Qëndroni larg sporteve ekstreme, pasi mund të dëmtoheni.

LUANI

Shumë luanë do të jenë spontanë, femënorë dhe të ëmbël. Një sjellje e tillë do tju mundësojë bonus në jetën tuaj personale. Ndërsa nga ana profesionale, gjithçka do të jetë ndryshe. Kontrolloni gjithçka rreth jush në punë.

VIRGJERESHA

Personat e kësaj shenje nuk duhet të punojnë me orare të zgjatura. Yjet do të vendosin se në cilën pikë do të keni sukses. Por mos u trishtoni, pasi suksesit do të vijë patjetër. Në pjesën e dytë të ditës do tju bëjnë një surprizë tejet të bukur.

PESHORJA

Disa personave të kësaj shenje do tju duhet të përballen me disa gabime nga e kaluara. Megjithatë, duke menduar pozitivisht, do ta kaloni një situatë të tillë. Në mbrëmje mund tju vijë një ftesë për të qenë pjesë e një eventit mes miqsh.

AKREPI

Personat e kësaj shenje do të jenë sot në krye të skuadrës. Mund tju besojnë organizimin e festës së Krishtlindjes, ose një udhëtim me familjen tuaj. Trajtoni çështjet personale me shumë përgjegjësi. Ka gjasa që të përfshihen në një incident për të cilin do përfillet gjatë.

SHIGJETARI

Shigjetarët do të vënë re sot dyshim ose frikë në sytë e partneres/partneres suaj. Ndoshta kjo mund të vijë si pasojë e disa ndryshimeve që kanë ndodhur kohët e fundit në marrëdhënien tuaj.

BRICJAPI

Do të kaloni një të martë shumë të qetë. Ka shanse që të arrihi rezultate mbresëlënëse në jetën profesionale, por njëkohësisht edhe të krijoni harmoni në fushën e dashurisë. Nëse keni kohë që dëshironi të flisni singlerisht me partnerin/partneren tuaj.

UJORI

Sot do të mund të përfundoni vetëm gjysmën e detyrave, të cilat kishit planifikuar të realizoni, pasi mund të sëmureni papritur. Do të ishte mirë që të pushonit dhe t'i kushtoni me shumë kohë vetes suaj. Në mbrëmje ka gjasa të merrni një lajm që do tju befasojë.

PESHQIT

Mund të ndryshojë komunikimi mes jush dhe një kolegu/kolegeje. Mund të lindë një ndjenjë e re mes jush. Sot mund të mendoni sesi të ecni përpara. Dikush do tju japë një këshillë, por nuk do të jetë e nevojshme ta merrni për bazë.

Nuk ka më dyshime. Presidenti i Ligës Profesioniste do të jetë Edvin Libohova. Zv. presidenti aktual i FSHF-së është zgjedhur në mënyrë unanime nga klubet e Kategorisë Superiore për të drejtuar këtë ligë. Mbetet për t'u parë nëse Libohova të heqë dorë nga funksionet aktuale që mban në FSHF (zv. president dhe anëtar i KE). Përveç angazhimeve në fushën e sportit,



pranë FSHF-së, Libohova është një ekspert i ekonomisë dhe sistemit bankar; gjë e cila ia shton kreditet për qenë

Zv. presidenti i FSHF-së merr mandatin historik

Klubet krijojnë Ligën Profesioniste, Libohova zgjidhet president

kryetari i parë i Ligës, kuptohet nëse do të ketë finalizim të procesit, pasi shpeshherë krijimi i kësaj strukturë ka dështuar në çastet e fundit. Ndërkohë, presidenti i sapozgjedhur, u shpreh: "Kemi dakordësuar të gjitha prob-

lemet që kishin me statutin dhe shumë shpejt do të fillojmë të rregullojmë marrëdhënien me federatën për kuadrin rregullativ, sepse Liga, pas krijimit të saj, do të jetë anëtare e FSHF-së. Qëllimi kryesor është industrial-

zimi i procesit dhe tani fillon puna reale. Hapi i parë do të jetë regjistrimi në gjykatë, por që është punë ditësh, pasi u arrit dakordësia. Nuk ka ndryshime. Nga pikëpamja e statutit, çdo klub i Superligës humbet të drejtën e

pjesëmarrjes në Ligë, sapo del nga Superiorja dhe e kundërta, çdo klub që ngjitet bëhet pjesë e Ligës. Nëse një klub hyn në Superligë dhe nuk pranon të jetë anëtar i Ligës, mund të vazhdojë, por pa përfitimet që vijnë nga Liga dhe kjo nuk u leverdis. Pozicioni im? Është kompetencë e asamblesë, sepse do bëhen ndryshime në statut që kryetari i Ligës do të jetë automatikisht pjesë e KE-së. Të tjerat do diskutohen më tej", - tha pas mbledhje Libohova.

Barça, Siti dhe Reali buzëqeshin. Totenemi "peshkon" Borussia. Roma-Porto, sfidë e barabartë

Champions: Short i pamëshirshëm! Liverpool-Bajern, kryesfida e 1/8-ave

Juventus do të ndeshet me Atletikon e Madridit



Jeton Selimi

Në Nion të Zvicrës u hodh shorti i Ligës së Kampionëve për përballjet me eliminim direkt, të cilat dhurojnë gjithnjë e më shumë emocione, pasi bëhet fjalë për ekipet më të mëdha të kontinentit që kanë mbetur në garë për trofeun më të lakmuar. Edhe në këtë edicion, përballjet e shortit pritet të jenë spektakolare, pasi kanë dhuruar sfida mes ekipeve shumë të forta të skuadrave pjesëmarrëse. Bien në sy sidomos tri sfida: Atletiko Madrid-Juventus, Manchester Junajtid-PSG e sidomos Bayern Mynih-Liverpul. Në të tria këto duela janë përplasje direkte mes skuadrave që kanë pretendime për t'i shkuar deri në fund turneut. Kampionët në fuqi të Realit do të përballen me Ajaksin, duel mjaft interesant është ai mes Totenhemit e Borussia. Buzëqeshin Barcelona e Manchester Siti, që do të ndeshen respektivisht me Lionin e Shalken.

Nënkampionët e vjetshëm, Liverpooli, do të kenë përballë kampionët e Gjermanisë, Bayern Mynihun. "Th Reds" po kalojnë një formë fantastike nën urdhrat e gjermanit Klop, ndërsa bavarezët kanë ndërruar trajner sivjet dhe po shfaqin probleme në drejtimin e kroatit Kovaç. Historia flet për ekipin anglez ku të kthejmë kokën mbrapa shohim 2 përballje mes këtyre ekipeve. Përballja e parë daton në sezonin

1980-1981, ku Liverpool pas barazimit 1-1 kalon me avantazhin e golit në fushën kundërshtare, pasi ndeshja e parë kishte përfunduar 0-0.

Përballja e dytë daton në vitin 2001, ku përsëri Liverpool ka arritur të fitojë 3-2 kundër Bayernit në kompeticionin që sot quhet Europa League. Përball-

ja pritet të jetë interesante dhe të gjithë janë me sytë nga Bayern për të ndryshuar faqen e historisë. Një nga përballjet më interesante të Ligës së Ka-

CHAMPIONS LEAGUE

SHORTI I 1/8-AVE

- Shalke - Manchester Siti
- Atletiko Madrid - Juventus
- Manchester Junajtid - PSG
- Totenhem - Borussia Dortmund
- Lion - Barcelona
- Roma - Porto
- Ajaks - Real Madrid
- Liverpool - Bayern Mynih

mpioneve në turin tjetër të turneut është padyshim ajo mes Atletiko Madrid dhe Juevntusit, dy skuadra me pretendime të mëdha në këtë turne dhe që kanë ambicie për t'i arritur deri në fund. Në dekadën e fundit, të dyja klubet kanë arritur nga 2 herë në finale, por asnjë prej tyre nuk ka bërë të vetin trofeun. E vetmja herë kur ato janë përballur në arenën ndërkombëtare ka qenë pak vite më parë, në fazën në grupe të edicionit 2014-2015. Asokohe, Atletiko fitoi ndeshjen e parë në shtëpi 1-0, ndërsa e dyta u nda në

barazim pa gola në Torino. Në radhët e spanjollëve aktivizohet edhe Mario Manxhukiq, i cili më pas u bë pjesë e Juventusit, i cili në atë edicion shkoi deri në finale. Paris Sën Zhërmeni është i kënaqur. Naser Al-Khelaifi, presidenti i PSG-së, ka folur për faqen zyrtare të klubit në lidhje me sfidën e dyfishtë ndaj Manchester Junajtid në Champions League. "Për herë të parë në histori, klubi ynë do të përballlet me Manchester Junajtid dhe dy ndeshjet me të premtojnë mbrëmje të mëdha në Champions League. Luajmë me një kundërshtar mjaft prestigjioz në këtë kompeticion dhe natyrisht që e respektojmë shumë. Tifozët tanë do të përjetojnë momente magjike si në Manchester, ashtu edhe në fushën tonë. Siç e kam thënë gjithmonë, duhet të jemi gati për të përballuar të gjitha skuadrat dhe besoj shumë se do t'ia dalim për t'u kualifikuar", - theksoi numri 1 i klubit parisien për shortin e Championsit.

EUROPA LEAGUE



Europa League këtë vit ka në përbërjen e 32 skuadrave më të mira disa emra shumë të njohur të kontinentit, ndaj do të ketë një shikueshmëri më të lartë. Në garë kanë mbetur skuadra si Çelsi, Arsenal, Inter, Napoli, Betis apo Sevija, duke e bërë këtë turne shumë entuziazmes deri në fund. Shorti ka qenë me fat për Interin, që ka peshkuar një skuadër relativisht të lehtë, si Rapid

Short me fat për pretendentët, Lacio-Sevilja përballja më e fortë

i Vjenës. Edhe Arsenali ka qenë më fat tekta ka gjetur përballë BATE Borisov, ndonëse është skuadër me eksperiencë ndërkombëtare. Ndërkohë, një finale e parakohshme është ajo e Lacios me Sevijen, pasi italianëve u ka rënë përballë skuadra më e vështirë e mundshme, rekordmëne e këtij turneu sa u përket trofeve të fituara dhe sigurisht pretendent


edhe në këtë sezon. Kurse Napoli i Elseid Hysajit do të udhëtojë drejt Zvicrës, ku do të ndeshet me Zyrihun e mbushur me shqiptarë, me emra si Kololli e Kryeziu, të cilët padyshim do të synojnë të shkruajnë historinë edhe ndaj gigantëve të drejtuar nga Ançeloti. Në vijim, mësoni ndarjet e shortit për të gjitha skuadrat pjesëmarrëse për këtë turne:

EUROPA LEAGUE

SHORTI I 1/16-AVE

- Viktoria Plzen - Dinamo Zagreb
- Klub Bryzh - RB Salcburg
- Rapid Vjenë - Internazionale
- Slavia Praga - Genk
- Krasnodar - Bajjer Leverkusen
- Zyrih - Napoli
- Malmö - Çelsi
- Shakhtar Donjetck - Eintracht Frankfurt
- Sëlittik - Valencia
- Ren - Betis
- Olimpiakos - Dinamo Kiev
- Lacio - Sevija
- Fenerbahçe - Zenit
- Sporting Lisbonë - Vijareal
- BATE Borisov - Arsenal
- Gallatasaraj - Benfika

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Mund të jetë një arkë.
8. Fillojnë ndeshjen
9. Paul që këndon Diana.
10. Spagna që këndon ën Itali.
13. Fillojnë lojën.
14. Gjysmë tepsie
17. Mund të jenë ekspres.
18. Qe babai i mjekësisë.
21. Eshhtë si ballon.
22. Lind një në kokë.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Një pjesë e edukatës.
27. Inicialet e Asimov.
28. Eshhtë e vrara në kufhtë.
30. Iglit Lazio.
31. Inicialet e Redford.
33. Mbetet në fund.
34. Pak analogji.

35. Eshhtë vdekje e autorizuar.
39. Një numër femrash.
42. Në krye të modernistëve.
43. Kërkojnë talent.
44. Mbetet në fund.
45. U vra me një grushgtn nga Odiseu
47. Bëhet në start.
49. Catherine aktore.
50. Ishte babai i Odiseut

VERTIKAL

1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një...FIAT.
3. Mbyllin një hark.
4. Eshhtë si sarkazmë.
5. Fillojnë ideologjinë.
6. Ushtrohet me cd false.
7. Në këtë moment.
8. King Cole i muzikës.
11. Janë si cilësi.
12. Fillojnë nazet.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. Janë binarët.
18. Nënkuptojnë edhe pranga.
19. Aktet pa kufij.
20. I takojnë fituesit.
21. Quinn aktor.
22. Pak inekzistente.
23. Fillojnë dobet.
24. Rrjeshtohen në kuvertë.
29. Eshhtë divorci.
32. Një pije piratësh.
33. Zanore për perime.
36. Një peshk i rëndë.
37. Enti amerikan i hapësirës.
38. Yll anglez.
40. Gripi pak ekstreme.
41. Tiran pa kufij.
46. Në hyrje të oazit.
48. Fillojnë ilustrimet.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Marple a Agatha Christie.
4. Zanore për zulu.
6. Qyteti i Protogora-s.
11. Inicialet e Lendi ish tenist.
12. Janë tek në kufij.
14. Benigni aktor.
16. Mund të jetë me mbret.
18. Gjysmë ndikim.
20. Një dru aromatik.
21. Teke trari.
23. Janë më numër të tilla ushtarake.
24. Nusja pa çifte.
25. Iglit Lazio.
26. Një pjesë e sipërfaqes.
27. Një fjalë... para kohe
28. Duken të gjata në pritje.
31. Skuadra merengue.
33. Eshhtë trofe sportiv.

VERTIKAL


1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Shkruhen për filma.
5. Janë malet ruse të tilla
6. Agjenci Botuese Lokale.
7. Një kostues i viteve shatërdhjetë.
8. Në krye të drejtuesve.
9. Eshhtë racë kombi.
10. Steiger aktor.
13. I vihen kalit.
15. Një britmë në corrido.
16. Një gjellë gratis.
17. Rolet pa zë.
19. Eshhtë e hollë dhe therëse.
20. Një brejtës pylli.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për gol.
27. Janë maskarenj.
28. Tre në tetëdhjetë.
29. Emri i parë i Fassbinder.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë Organoziata e skuadrave të Formula 1.
35. Mbyllin punimet.
37. Ndoth në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Pak tradicionale.
41. Një cigan.
43. Fillojnë lehtë.
45. Mbyllin një manastir.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

1	2			7		4
			2	4		7
			8		1	9
7				9		1
9	5	3			4	
	6		3	5		7
	9		7			5
3		7	9	2		8
6						8

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	4	6	7	5	8	3	1	9
3	5	8	6	9	1	4	7	2
7	9	1	2	3	4	6	5	8
4	8	9	1	2	3	7	6	5
5	6	2	4	7	9	8	3	1
1	3	7	5	8	6	2	9	4
6	7	4	8	1	5	9	2	3
8	1	3	9	6	2	5	4	7
9	2	5	3	4	7	1	8	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Një kafshë që do të dinte të fliste, do të thoshte: "Njerëzimi është një paragjykim nga i cili të paktën ne kafshët e tjera nuk vuajmë".



- Ne nuk i konsiderojmë kafshët si qenie morale. Por mos vallë mendoni se ne kafshët na mbajnë për qenie morale?

-Dhe njerëzit ndryshojnë vetëm në shkallën e çmendurisë. Ndoth që dikush të jetë më i çmendur se ju ndërsa ju jeni disi më pak.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJES TË NUMRIT TË KALUAR

L	A	U	R	A	K	O	H	A	A	P
V	O	L	T	A	D	O	G	A	N	A
A	R	I	E	M	I	M	R	S	E	
D	E	R	I	P	A	R	T	I	M	
U	H	P	A	K	E	T	I	M	E	T
Z	E	M	E	R	A	K	E	T	S	T
F	I	D	A	N	E	T	V	E	T	E
S	E	N	A	T	I	I	B	E	R	I
S	E	N	E	K	A	L	L	A	P	A
L	T	R	E	E	L	S	A	K	T	
L	I	V	E	T	A	K	A	D		
N	A	A	R	N	J	E	A	P	E	L
B	A	Z	A	R	V	A	K	A	N	T
E	D	E	N	P	N	A	D	I	A	L
S	R	E	P	T	I	E	T	T	R	I
T	E	S	T	R	I	A	T	E	O	L
S	M	N	O	T	A	R	E	T	E	N
K	A	Z	A	R	N	J	E	A	P	E
E	H	P	A	M	E	R	I	K	A	N
K	O	L	O	N	A	K	T	E	C	E
T	U	N	E	L	E	T	R	E	R	O
A	T	A	A	I	T	S	A	R	A	H
E	T	A	T	K	A	T	E	T	E	T



Thënie të mënçura

- Misteri i jetës nuk është një problem për t'u zgjidhur, por një realitet që ne duhet të përjetojmë.
- Mos kujtoni se nuk ka kafshë, vetëm dhe vetëm sepse pylli është i qetë ..

- Ekziston mbrojtje kundër çdo gjëje që ekziston.
- Kundër zjarrit, stuhisë dhe të ftohët.
- Po, kundër asaj që mund të mendoni. Vetëm nga njeriu nuk do të gjeni asnjë.
- Interesi që më ngjall një gjë, më bën ta ndjek atë çfarë saqë përfuncion duke mbërritur në fund të saj dhe vë re se ajo nuk ia vlenë mundimin që i kushtova.

